



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Raportimi vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Agron Shehaj, Përparim Spahiu, Reme Lala, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj.

Të ftuar:

Bujar Leskaj - Kryetar i KLSH-së

Lindita Lati - Drejtore e Përgjithshme në KLSH

Manjola Naço - Drejtore e Përgjithshme në KLSH

Rinald Muça - Drejtor i Departamentit të Performancës

Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme

Kozma Kondakçi, Drejtor i Teknologjisë së Informacionit

HAPET MBLEDHJA

Erjon Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit.

Siç jeni njoftuar sot në rendin e ditës të punës së këtij komisioni kemi dy çështje:

Së pari, është raportimi vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017, veprimtaria e punës së tij.

Së dyti, është një propozim që i paraqitet komisionit nga ana ime për ngritjen e një nënkomisioni që do të merret drejtpërdrejtë me çështjet e transparencës, mbikëqyrjes dhe zbatimit të buxhetit të shtetit dhe të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Për pikën e parë ndodhet në Komisionin e Ekonomisë kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, zoti Bujar Leskaj, së bashku me zonjën Lindita Lati, drejtore e Përgjithshme, zonjën Manjola Naço, drejtore e Përgjithshme, zotin Rinald Muça, drejtor i Departamentit të Performancës, zonjën Luljeta Nano, sekretare e Përgjithshme dhe zotin Kozma Kondakçi, drejtor i Teknologjisë dhe Informacionit.

Relatore e komisionit lidhur me këtë çështje është zonja Blerina Gjylameti. Do të procedojmë me prezantimin nga ana e kryetarit të KLSH-së e raportit për veprimtarinë gjatë vitit 2017.

Pastaj do të vazhdojmë me relatoren e komisionit.

Zoti Leskaj, keni fjalën.

Bujar Leskaj – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë të pranishëm dhe ju që shkëlqeni me mungesën,

Ne, siç e dinë të gjithë qytetarët dhe fshatarët shqiptarë jemi institucion i pavarur kushtetues, jemi përpjekur që në këto vite ta zhvillojmë veprimtarinë tonë mbështetur tërësisht në parimet kushtetuese, nenet 162, 164 që rregullojnë veprimtarinë e KLSH-së, mbështetur në ligjin organik nr.154 të vitit 2014 “ Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, kuadrin rregullator në fuqi, si edhe duke u mbështetur në standardet tona ndërkombëtare të auditimit. Këtë viti ne kemi menduar që raportin tonë vjetor të performancës ta bëjmë në një format inovativ, i cili bazohet në kornizën e matjes së performancës së SAI-ve, që është një dokument i miratuar në kongresin e fundit të INTOSAI-t, që është Kongresi i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të

Auditimit në mbarë botën i miratuar në dhjetor të vitit 2016 në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Katër janë kolonat ku mbështetet puna jonë: Kushtetuta, ligji organik i KLSH-së dhe korpusi ligjor në fuqi. Janë standardet ndërkombëtare të auditimit, manualët e auditimit, udhëzuesit dhe dokumentet e institucioneve profesionale të fushës si : SIGMA, IPAK-u dhe institucione të tjera, si edhe dy rezolutat e Kombeve të Bashkuara në harkun kohor të 3 vjetëve dhjetor 2011-dhjetor 2014. Kombet e Bashkuara kanë miratuar dy rezoluta, të cilat i kushtohen posaçërisht rolit dhe mbështetjes që parlamentet e vendeve anëtare të OKB-së duhet t'u japin institucioneve supreme të auditimit të vendeve të tyre.

Në kolonën e katërt, e cila për ne është shumë e rëndësishme janë rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë si institucion për të cilin ne si institucion suprem i auditimit na shërbejnë si *watchdog*, siç njihet në literaturë për të dhe për qytetarët shqiptarë. Të gjithë formatin e analizës sonë e kemi mbështetur në një bllok-skemë, e cila është pjesa kryesore e këtij dokumenti, në të cilën ne përshkruajmë kapacitetin institucional të saj, vlerat dhe përfitimet e saj (ne e kemi përcjellë këtë edhe në komisionin tuaj, të nderuar deputetë, nuk është te përmbledhja e treguesve, por është fletë më vete) udhëheqja e saj dhe kultura, të analizuar, në kontekstin e vendit, qeverisja dhe ambienti i zhvillimit të financave publike.

Kuadri i matjes së performancës së saj është i grupuar sipas 6 fushave, të cilat nga ana e tyre e mbështesin punën e tyre në 25 tregues. Secili tregues përmban 2-4 dimensione, të cilat analizohen në bazë të një sërë kriteresh. Kjo është një piramidë sistemi i treguesve të kornizës së matjes së performancës së saj, e cila jep në mënyrë sintetike analizën tonë. Gjashtë fushat në të cilat ne e zhvillojmë analizën e performancës së një institucioni suprem të auditimit janë:

- A) Pavarësia dhe korniza ligjore.
- B) Qeverisja e brendshme dhe etika.
- C) Cilësia e auditimit dhe raportimi.
- D) Menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse.
- E) Burimet Njerëzore dhe Trajnimi.
- F) Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit.

Këtë do të ndjek edhe unë përgjatë këtij raportimi të shkurtër, para se të kaloj konkretisht te roli i kornizës së matjes së performancës së saj në zhvillimin e kapaciteteve. Në rast se do të shikojmë bllok –skemën e paraqitur vlerësimi i kornizës së performancës së saj në radhë të parë bazohet mbi atë plan strategjik që çdo institucion suprem auditimi

ndërton. Viti 2017 ishte viti i fundit i strategjisë së zhvillimit të institucionit tonë 2013-2017, njëherazi edhe një vit në të cilin ne përgatitëm dhe në fundin e vitit lançuam strategjinë e re 2018-2022. Nga plani strategjik i saj, ne kalojmë në planin e veprimit të zhvillimit të institucionit suprem të auditimit që bëhet fjalë për një vit, plan, i cili për vitin 2017 u miratua në fundin e vitit 2016, plani i auditimeve dhe vlerësimeve që do të zhvillojmë. Për të vazhduar më tej me implementimin e planit të veprimit të zhvillimit të SAI-ve. Gjatë këtij procesi ne monitorojmë progresin dhe matim performancën e institucionit tonë duke identifikuar avantazhet dhe dobësitë, duke investiguar çështje të ndryshme në shqyrtim.

Për të kaluar (kjo i vlen jo vetëm institucionit suprem të auditimit, por në radhë të parë Kuvendit) të rekomandimi dhe masat për zhvillimin e kapaciteteve të saj. Është Kuvendi i Shqipërisë institucioni legjitim, konkretisht Komisioni i Ekonomisë që përmes rezolutave të tij apo përmes dokumenteve të ndryshme jep rekomandime, orientime për punën e saj.

Të 6 fushat që përmenda më parë, janë analizuar përmes një metode nga ne, si institucion suprem auditimi përmes një metode të gërshtuar.

Së pari, përmes metodës së vetëvlerësimit.

Së dyti, përmes *Peer review*, që është proces rishikimi përmes kolegësh, e cila është organizuar nga institucione supreme të auditimit të Austrisë dhe të Polonisë.

Nga një vlerësim që i kemi bërë performancës së KLSH-së bazuar në këtë kornizë sikurse paraqitet në grafikun, në tabelën në krahun e majtë që është përgatitur nga KLSH-ja treguesit e agreguar sipas fushave identifikojnë se KLSH-ja ka një performancë mbi nivelin mesatar, për 3 nga 6 fushat vlerësimi është 4, vlerësimi është nga zero deri në 4. 4 është vlerësimi maksimal. Për 3 fusha vlerësimi është 3 nga 4 që është vlerësimi maksimal.

Pavarësia dhe korniza ligjore

Vlerësimi i kësaj fushe të performancës së KLSH-së është bazuar kryesisht në vlerësimin zyrtar në kuadër të INTOSAI-t realizuar nga Gjykata Austriake e Auditimit, përmes procesit *Peer Review* proces rishikimi mes kolegëve. Kjo kornizë sanksionon pavarësinë organizative në planin e auditimeve, në strukturën dhe stafet e nevojshme për t'iu përgjigjur detyrimeve kushtetuese dhe aktivitetit të përditshëm auditues. Pavarësia e kryetarit është një element që sanksionohet në mënyrë të kujdesshme në ligjin e ri nr.154 të këtij viti, që miratua falë bashkëpunimit dhe falë udhëheqjes nga Komisioni i Ekonomisë. Pavarësia sanksionohet në mënyrë të kujdesshme në ligjin e ri, fakt i cili bëri që dimensionet e lidhura me pavarësinë të kenë një vlerësim maksimal. Te kjo fushë janë dy tregues, pavarësia e saj

dhe mandati i saj. Korniza kushtetuese dhe efektive është vlerësuar me 4, me maksimumin. Pavarësia, autonomia financiare është vlerësuar me 3. pavarësia autonomia organizative me 4, pavarësia e kryetarit të saj dhe zyrtarëve të tij me 4, pra me maksimumin.

Mandati i KLSH-së është vlerësuar duke analizuar dimensionin e mjaftueshmërisë së mandatit, lidhur me të drejtën për të audituar dhe kufizimet lidhur me këtë të drejtë. Vlerësimi tregoi se KLSH-ja ka një mandat të mjaftueshëm për të përmbushur misionin e saj, mandat që në tërësi të tij nuk ka kufizime që cenojnë punën tonë. Ky dimension, që është një tregues shumë i rëndësishëm në çdo institucion suprem auditimi të botës në këtë institucion, në Shqipëri vlerësohet maksimalisht jo vetëm nga ne, por edhe nga komuniteti ndërkombëtar.

Në vlerësimin që sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t dha në Lima, Peru më dhjetor të vitit 2017, në një aktivitet të organizuar me rastin e 40 - vjetorit të Deklaratës së Limës, e cila është kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit në botë, në mënyrë eksplicite theksohet se: “ Pavarësia, mandati dhe organizimi i KLSH-së janë ligjërisht *de facto* të vendosura dhe të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga ligji për KLSH-në. Me hyrjen në fuqi të ligjit në vitin 2015, KLSH-ja pati përmirësime të rëndësishme në pavarësinë e saj, krahasuar me dispozitat e ligjit të mëparshëm. Korniza ligjore e vendosur është e përshtatshme, efektive dhe qëndron në pajtueshmëri me Deklaratën e Meksikës”.

Përveç vlerësimit pozitiv, kolegët e Gjykatës Austriake të Auditimit cilësuan si aspekt që ka nevojë për përmirësim dhe ndikon në forcimin e pavarësisë reale dhe pavarësinë financiare.

Pavarësisht faktit që buxheti i KLSH-së dhe numri maksimal i punonjësve janë pjesë e buxhetit të shtetit të miratuar nga Kuvendi, fakti që kryetari nuk ka të drejtë ankimimi të drejtpërdrejtë në Kuvend apo në Komisionin e Ekonomisë për çështje që lidhen me buxhetin e KLSH-së, është aspekt që cenon pavarësinë reale financiare të KLSH-së dhe për këtë arsye është vlerësuar me 3 nga 4 që është vlerësimi maksimal.

Liria e plotë në shpërndarjen e buxhetit, si për shembull, dhënia e buxhetit si shumë totale dhe dhënia e të drejtës së KLSH-së për akordimin e saj në mënyrë autonome, do të nënkuptonte përmbushjen e Deklaratës së Meksikës në një shkallë më të lartë. Më duhet të theksoj këtu se personalisht, si kryetar dhe drejtuesit e KLSH-së e kemi mirëkuptuar Kuvendin e Shqipërisë, duke respektuar kornizën ligjore në fuqi dhe faktin që kërkojmë një respektim rigoroz të ligjit për buxhetin organik të shtetit.

Sipas kornizës ligjore, KLSH-ja ka mandat të mjaftueshëm dhe akses të plotë në informacion, pasi korniza ligjore është e plotësuar sipas standardeve ndërkombëtare të lidhura me të drejtën dhe mandatin për të audituar. Megjithatë gjatë vitit 2017, përsëri kemi ndeshur raste sporadike, të cilat nuk e cenojnë të drejtën që ne kemi fituar aksesin e pakufizuar në informacion, por këto raste kanë dëmtuar disi këtë tregues. Përmend këtu rastin e “Albpetrol”, i cili u zgjidh falë vullnetit dhe zbatimit të detyrimeve ligjore nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ne realizuam objektivin tonë.

Kemi edhe një problem tjetër, ne nuk po lejohejmë të auditojmë në Entin Rregullator të Energjisë, për të cilin unë i jam drejtuar edhe Kuvendit të Shqipërisë. U jemi drejtuar edhe institucioneve të tjera të gjyqësorit. Megjithatë edhe këtu ne kemi ditur të nxjerrim problematikat nga auditimi që u kemi bërë shoqërive KESH dhe OSHEE, të cilat janë të lidhura me vendimmarrjen.

Fusha, qeverisja e brendshme dhe etika

Kemi 4 tregues në këtë fushë: cikli i planifikimit strategjik, mjedisi i kontrollit organizativ, auditimet me burimet e jashtme, udhëheqja dhe komunikimi i brendshëm dhe planifikimi i përgjithshëm i auditimit.

Qeverisja e brendshme, si fushë e rëndësishme që ndikon në performancën institucionale të çdo institucioni suprem uuditimi, është vlerësuar në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit nr. 10, 12, 20, 30 dhe 100. Dimensionet që vlerësohen në fushën B, pasqyrojnë themelet e SAI-t për kryerjen e aktiviteteve të tij. Sistemi i vetëvlerësimit konkludon: “KLSH-ja është drejtuar duke dhënë shembullin e mirë, duke synuar të jetë organizatë model, si dhe ka promovuar transparencën dhe llogaridhënien përmes mirëqeverisjes dhe sjelljes etike”.

Në aspektin e qeverisjes së brendshme dhe etikës, vlerësimi bazohet në matjen e ciklit të planifikimit strategjik, ku përfshihen: plani strategjik, plani vjetor, planifikimi organizativ dhe monitorimi, si dhe raportimi i performancës institucionale.

Me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe konsolidimin e reformave të ndërmarra në përputhje me detyrimet kushtetuese, me standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI-t, me rekomandimet e progresraporteve të BE-së, si dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit, menaxhimi i ndryshimit dhe zhvillimi institucional është realizuar, duke e konsideruar implementimin e objektivave strategjike si një proces dinamik, duke rivlerësuar, përditësuar, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet e

objektivave strategjike. Kujtojmë strategjinë e zhvillimit të KLSH-së, e cila është 4-5 – vjeçare dhe e apdetojmë 1 herë në 2 vjet, pas një analize që bëjmë.

Raportet e monitorimit kanë shërbyer edhe si një instrument i informimit dhe transparencës për palët e interesit si: publiku, Kuvendi, Komisioni European, si edhe të gjitha organizmave ndërkombëtarë, të cilëve u mundësohet vlerësimi i progresit të zhvillimit institucional.

Mjedisi i kontrollit organizativ është vlerësuar përmes dimensioneve të lidhura me mjedisin e kontrollit të brendshëm, etikën dhe integritetin, përmes sistemit të kontrollit të brendshëm, sistemit të kontrollit të cilësisë dhe sistemit të sigurimit të cilësisë. Të gjitha këto dimensione vlerësohen në përputhje me kërkesat e udhërrëfyesve metodologjikë, modelit COSO, modelit INTOSAINIT e të tjera.

Nga pikëpamja metodologjike, këta tregues vlerësohen me 4 pikë kundrejt 4, përveç sistemit të kontrollit të cilësisë, ku duhet të përmirësojmë instrumentet metodologjike për matjen e risqeve që lidhen me cilësinë. Për të arritur këtë, duhet të kemi një sistem për të përcaktuar përparësitë e punës, duke marrë parasysh nevojën për të ruajtur cilësinë, në zbatim të kërkesave të standardit ndërkombëtar të auditimit ISSAI-t 40.

Mjedisi i kontrollit të brendshëm, etikës dhe integritetit

Duhet të theksojmë se veprimtaria menaxheriale institucionale, jo vetëm në vitin 2017, ka pasur një vazhdimësi këta 6 vjetët e fundit, duke u fokusuar në sigurimin e sistemit të etikës dhe të integritetit institucional, nëpërmjet zbatimit të kornizës rregullative të KLSH-së dhe praktikave më të mira të komunitetit të INTOSAI-t, specifikisht të INTOSAINIT që është instrumenti i vetëvlerësimit të integritetit. Strategjia për implementimin e një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit është fokusuar në tre shtylla kryesore:

1.Hartimi dhe konsolidimi i kuadrit rregullator mbi etikën dhe integritetin.

KLSH-ja është radhitur ndër të parat institucione supreme të auditimit, që në mënyrë vullnetare, që prej vitit 2014, ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit INTOSAINIT, konsideruar si një nga metodat inovative dhe të efektshme, me impakt në zhvillimin e politikave të integritetit. Parimi kryesor i zbatimit të kësaj metodologjie është vetëvlerësimi dhe çelësi i suksesit të aplikimit të këtij instrumenti është roli aktiv dhe kontribuues i çdo individi, pjesë e stafit të institucionit.

KLSH-ja ishte një ndër kontribuueset e hartimit të draftin të ri të standardit ndërkombëtar të auditimit ISSAI 30 “Kodi i Etikës”, i cili u miratua në Kongresin e XXII-të të INTOSAI-t në Abu Dabi, në dhjetor të vitit 2016. Në korrik të vitit 2017, KLSH-ja u bë

anëtare e grupit të projektit të EUROSAT-t “Mbi rolin e institucioneve supreme të auditimit në përhapjen e kulturës etike në sektorin publik”, i cili udhëhiqet nga SAT i Hungarisë. KLSH-ja nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në këtë grup pune, synon ushtrimin e auditimit të etikës dhe integritetit në subjektet e auditimit të sektorit publik. Në këto 2 vjet ne e kemi implementuar brenda institucionit tonë për të vazhduar edhe me institucione të tjera.

Shtylla e dytë, për sa i përket strategjisë, implementimit të sistemit të integritetit është menaxhimi i etikës dhe integritetit, duke vijuar me imponimin dhe implementimin e rregullave, të procedurave dhe të udhëzimeve. Në këtë aspekt janë kryer trajnime intensive që kanë synuar edukimin e punonjësve me frymën e standardeve etike dhe të vlerave morale.

Shtylla e tretë është ushtrimi i funksioneve mbikëqyrëse, kontrolluese, investiguese dhe ndëshkuese ndaj sjelljeve dhe shkeljeve të etikës dhe integritetit. KLSH-ja si rezultat i aplikimit të këtij instrumenti ka marrë masa ndaj punonjësve të tij, të cilët kanë rezultuar me shkelje të rregullave të etikës dhe të integritetit. Për periudhën 2012-2017 komisioni i etikës i institucionit ka vendosur për 10 largime nga detyra për shkelje të etikës dhe integritetit dhe për një sërë largimesh të tjera duke i kombinuar me arsyet e nivelit të pamjaftueshëm profesional, çka është një nivel i konsiderueshëm në raport me institucionet e tjera, por edhe në raport me numrin e audituesve që ne kemi.

Me shkresën numër 1182, datë 18. 11. 2016 të kryetarit të KLSH-së, i kemi kërkuar zyrtarisht inspektorit të përgjithshëm të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ILDKPKI, kryerjen e verifikimit të plotë e të thelluar mbi deklaratimet e të gjithë punonjësve, drejtuesve të KLSH-së, që mbartin detyrimin ligjor për deklaratim të interesave private.

Niveli drejtor dhe auditues. Për këtë, nga institucioni përgjegjës u kryen verifikime, bazuar në kërkesat e ligjit përkatës, për njëzet e tetë drejtues, dhe në përfundim të këtij procesi nuk rezultuan shkelje të kuadrit rregullator. Këtë vit, ne do të ndërmarrim një nismë, që të gjithë audituesit e KLSH-së të futen nën suazën e të qenit të kontrolluar nga Inspektoriatit i Lartë i Deklarimit të Pasurive. Në lidhje me këtë do të kërkojmë përmirësime ligjore.

Sistemi i kontrollit të brendshëm është vlerësuar në bazë të modelit të kohës. Përgjatë vitit 2017, KLSH ka vijuar me veprimtarinë menaxherial-institucionale, e suportuara nga një qeverisje e brendshme efektive dhe nga mirëfunksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në zbatim të INTOSAI 20, KLSH vepron mbi themelet e transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu, në zbatim të ISAI 12, që thekson parimin e udhëheqjes nëpërmjet shembullit, kryetari dhe menaxhimi i lartë janë përgjegjës për dhënien e shembullit të mirë, për të promovuar integritetin, po gjithashtu për të mundësuar përmbushjen efektive të mandatit të organizatës, duke zhvilluar një kulturë organizative, e cila promovon eficiencë, transparencë dhe përgjegjshmëri.

Në këtë kontekst, në vitin 2018 u rishikua kodi i etikës, dhe në veçanti u miratua kodi i etikës i kryetarit dhe i drejtuesve të lartë të KLSH-së, në të cilin, krahas kodit të etikës së audituesve, që ne e kemi qysh prej viteve 2000, e në veçanti në vitin 2012 kemi një variant më modern të tij, në kuptimin e plotë të fjalës, brenda komunitetit tonë, si shtyllë të dytë kemi që kryetari i KLSH-, duke vlerësuar maksimalisht, pranon pa asnjë kusht dhe zbaton në të gjithë veprimtarinë e tij kodin e etikës së deputetëve, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në këtë legjislaturë.

Komunikimi i brendshëm është një nga aspektet kryesore për ta mbajtur stafin e KLSH-së të informuar, të motivuar dhe në të njëjtin drejtim me objektivat e institucionit. Ai është një mjet i fuqishëm për të stimuluar rritjen e angazhimit të stafit. Përveç kësaj, trupa audituese luan një rol të rëndësishëm në komunikimin me qytetarët, duke nxjerrë në pah rëndësisë e KLSH-së për miradministrimin e parasë dhe të pasurisë publike. Prandaj, të gjithë audituesit dhe punonjësit tanë janë të informuar për punën dhe prioritetet strategjike të KLSH-së. Gjithashtu, komunikimi i brendshëm është konsideruar një mjet i rëndësishëm për shkëmbimin e njohurive, duke mundësuar punonjësit të njohin iniciativat e ndërmarra në të gjithë institucionin, rritjen e inovacionit dhe gjenerimin e ideve të reja, mbështetur kjo edhe mbi parimin fundamental të institucioneve supreme dhe të auditimit, *experientia mutua omnibus prodest*, eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve.

KLSH ka ndërtuar sistemin për të përcaktuar përparësitë e punës në ruajtjen e cilësisë, duke zbatuar metodologjinë bazuar në risk për përcaktimin e auditimeve që do të kryejë. Megjithatë, kriteri i vlerësimit sistematik të riskut përgjatë gjithë fazave të planifikimit, është një aspekt që duhet përmirësuar më tej. Për këtë arsye, ky dimension është vlerësuar me 3, nga 4 pikë maksimale.

Në lidhje me përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të dimensionit “Përmbajtja e Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit”, u konstatua se KLSH duhet të përmirësojë sistemin e vlerësimit të pengesave dhe të riskut, për përcaktimin e prioritetëve të auditimeve, buxhetin dhe burimet njerëzore në dispozicion.

Fusha C, fusha e tretë: “Cilësia e auditimit dhe raportimi”

Përmes këtij dimensionit: “Cilësia e auditimit dhe raportimi”, synohet vlerësimi i cilësisë së punës audituese, si dhe rezultatet e auditimit, aspekt që përbën aktivitetin kryesor të KLSH-së për të tre llojet e auditimit, përkatësisht auditimet financiare, të performancës dhe të përputhshmërisë. Në këtë periudhë, ne si KLSH, siç e dini, kryejmë edhe auditime të rregullshmërisë, si një fazë transitore për të kaluar vetëm në auditimet e performancë financiare dhe të përputhshmërisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar - dhjetor 2017, ka kryer 156 auditime nga 154 auditime të planifikuara. Siç e keni edhe në tabelë, nga këto janë: 25 auditime përputhshmërie; 14 auditime financiare; 15 auditime performanca; 5 auditime tematike; 5 auditime të IT-së. Janë edhe 92 auditime rregullshmërie.

Performanca e KLSH-së për secilin lloj auditimi vlerësohet në tre drejtime kryesore: parimet, procesi dhe rezultatet. Në rast se e shikojmë, struktura e sektorit publik të audituar, është skema që shfaqet në monitor.

Për sa u përket institucioneve të qeverisjes së përgjithshme, ne kemi audituar 69 institucione qendrore, projekte me financim të huaj: 11; në qeverisjen vendore, 59 njësi të vetëqeverisjes vendore; 16 shoqëri aksionere në korporatat publike, institucione të nivelit qendror e vendor, 15 auditime të performancës, ne i kemi zhvilluar dhe i kemi shtrirë këto auditime në 110 institucione qendrore e vendore.

Nga auditimet e ushtruara përgjatë vitit 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 11, 5 miliardë lekë ose 85, 8 milionë euro; shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 99.05 miliardë lekë, afërsisht 739 milionë euro, nga të cilat 92, 7 miliardë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 692.1 milionë euro, dhe 6.3 miliardë lekë, afërsisht 47, 8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve.

Gjithashtu, për vitin 2016, pasi në vitin 2017, kuptohet, analizojmë zbatimin e buxhetit të vitit 2016, rritja e detyrimeve tatimore e doganore, pra borxhi tatimor e doganor, si dhe rritja e borxhit të skemës së sigurimeve shoqërore është në vlerën 51, 17 miliardë lekë, ose 41 % më e lartë se në vitin 2015.

Dëmi i konstatuar është në një trend rritës në vitet e fundit dhe kjo duket qartë në paraqitjen grafike të mëposhtme. Në paraqitjen në monitor, ne kemi dhënë dëmin ekonomik të zbuluar nga KLSH, duke kërkuar për t’u zhdëmtuar nga viti 2002 deri në vitin 2017.

Treguesi i dobishmërisë së auditimit, i cili është raporti i sasisë së fondeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me fondet që buxheti i shtetit shpenzon për Kontrollin e Lartë të Shtetit, me fondet që buxheti i shtetit shpenzon për Kontrollin e Lartë të Shtetit: shpenzime operative, paga, shpenzime në investime e të tjera. Pra, shpenzimet në total.

Për vitin 2017, ky tregues rezulton 31, 9 lekë. Pra, për çdo 1 lek të shpenzuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zbuluar 31, 9 milionë lekë dëme. Në rast se e krahasojmë këtë tregues, indikatorin e dobisë së auditimit, për dhjetë vjet, nga viti 2002 deri në vitin 2011, me këtë tregues të periudhës gjashtëvjeçare, që KLSH drejtohet prej meje, 2012 – 2017, ky tregues është pesë herë më i lartë. Nga 21, 1 lekë, që ishte në periudhën 10-vjeçare, në këto gjashtë vjet ky tregues është 108, 7 lekë.

Edhe përgjatë vitit 2017, KLSH ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara, struktura e të cilave ka ruajtur të njëjtën tipologji sikurse vitet e tjera. Masa për përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore. Për periudhën janar-dhjetor janë dhënë janë propozuar gjithsej 3521 masa, nga të cilat janë pranuar 1937 ose 55% e masave të rekomanduara, ndërsa 1584 masa janë duke u shqyrtuar nga subjektet.

Në zbatim të rezolutës që ju keni miratuar, të korrespondencës e të planit të veprimit që ne kemi ndërtuar, por edhe të një kërkesë që progres-raporti i BE-së e ka shtuar, mbështetur mbi sugjerimet tona si Kontroll i Lartë i Shtetit, në fund të gjashtëmujorit ne do të raportojmë përsëri në Komisionin e Ekonomisë. Ne do të përcjellim materialin, ndërsa ju do të vendosni për raportimin tonë, kuptohet, në lidhje me gjithë zbatimin e rekomandimeve përgjatë vitit 2017, pasi për auditimet e realizuara në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017, ne jemi të detyruar të respektojmë atë periudhë gjashtëmujore, që ligji u njeht subjekteve për të zbatuar rekomandimet tona, si dhe na e njeht edhe ne kërkesën për të kërkuar llogari në lidhje me zbatimin ose moszbatimin e rekomandimeve tona.

Kemi masa për përmirësime ligjore, vetëm këtë do të përmend. Ne kemi bërë 91 propozime për përmirësime ligjore, nga të cilat janë pranuar 29, dhe janë në proces shqyrtimi 62. Me të drejtë, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Ruçi, në fjalën e tij përshëndetëse në aktivitetin që ne organizuam me SIGMA-n për raportet efektive e eficiente ndërmjet KLSH-së dhe Kuvendit, theksoi se Kuvendi i Shqipërisë pret më shumë propozime për përmirësime ligjore, e gjithashtu na premtoi më shumë vëmendje ndaj rekomandimeve tona.

Për sa i përket zbatimit të masave, më duhet të theksoj këtu, se ne vërtetë jemi në një tregues normal, në një tregues mesatar, krahasuar me simotrat tona europiane, por mangësia jonë, pika ku ne çalojmë, që është një dobësi e tërë sistemit shqiptar, e cila ka nxitur dhe favorizuar kulturën e pandëshkueshmërisë, është se largimi i zyrtarëve të lartë, të cilët rezultojnë me shkelje nga auditimet e KLSH-së, e që propozohen nga KLSH-ja për largim, është në shifra shumë të ulëta, në masën 25 %. Kjo duhet të na bëjë të reflektojmë të gjithë.

Duke synuar rritjen e nivelit, edhe këtë vit, shkeljet më të mëdha, me efekte të qenësishme në shpenzimin e fondeve, në kundërshtim me kërkesat ligjore, mbeten në fushën e keqmenaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të fondeve buxhetore, keqadministrimi i pronës shtetërore, pasuar nga parregullsitë dhe inefficiencat e fushës së prokurimit publik.

Duke synuar rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga institucionet publike, KLSH ka nxitur bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe institucionet e tjera qendrore e të pavarura, për të zbatuar një sistem të përbashkët për rekomandimet e dhëna, si nga auditimi i jashtëm ashtu edhe ai i brendshëm, duke synuar rritjen e nivelit të kontrollit në përgjegjshmërinë e zbatimit të rekomandimeve, si një instrument për të luftuar keqpërdorimin e parasë dhe pasurisë publike.

Miratimi kohët e fundit, në fillim të kësaj legjislature, nga Kuvendi i Shqipërisë, i një mekanizmi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së dhe institucioneve të tjera, mendojë se do të na mundësojë një hap cilësor, të ndjeshëm në këtë drejtim edhe neve si institucion suprem auditimi.

Standardet e Auditimit dhe Menaxhimit të Cilësisë.

Auditimi financiar përbën një nga aktivitetet audituese më tradicionale, por për shkak të niveleve të deformuara të raportimit financiar në sektorin publik, pas viteve 90-të, për praktikën e KLSH ende vijon të mbetet një lloj i ri auditimi, ose më saktë një auditim që ka nevojë për përsosje, ka nevojë për zgjerim, ka nevojë për shtim numri të auditimeve dhe për përmirësim cilësie. Për vitin 2017, nga KLSH është dhënë opinion për pasqyrat financiare të 14 njësive publike.

Numri mbetet akoma i vogël, por në kushtet e realitetit shqiptar, kur kemi mungesë të një kornize të plotë të raportimit financiar në sektorin publik, mungesë të pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, mungesë të pasqyrave të konsoliduara në nivel qendror, ku raportimi financiar nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri realizohet mbi bazën e mjeteve monetare, por me elementë të administrimit të aktiveve, të angazhimeve,

debitorëve dhe kreditorëve, niveli i mbulimit nuk është tregues që mund të reflektojë kriteret e kërkuara sipas standardeve të auditimit.

Theksoj se, personalisht, në cilësinë e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e kam shprehur që në prezantimin e parë në Kuvend, në vitin 2012, kur në fuqi ishte qeveria e mëparshme, qeveria “Berisha”. Kemi vazhduar në vijimësi, çdo vit, të theksojmë e të kërkojmë këtë, pra të kërkojmë pasqyrat e konsoliduara financiare të shtetit.

Gjatë këtyre viteve, opinioni i KLSH mbi raportimin financiar në sektorin publik ka qenë i fokusuar vetëm në aspekte të caktuara dhe është shoqëruar me kërkesa të përsëritura, për nevojën që raportimi financiar në sektorin publik të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, IPSAS. Kjo situatë ka sjellë që KLSH, në harmoni me zhvillimet e raportimit financiar në sektorin publik të drejtuar nga qeveria, të punojë me qëllim garantimin e kapaciteteve institucionale të përshtatshme, për të kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtarë të auditimit mbi pasqyrat financiare të sektorit publik, të përgatitura në përputhje me IPSAS. Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2017, KLSH ka vijuar me kryerjen e auditimeve financiare në disa njësi publike, por këto vite po ndihmohemi në këtë fushë edhe nga ekspertiza e SAI-t polak, NIK- ut polak, i cili ka angazhuar ekspertë të tij, në kuadër të projektit që ne kemi, në mbështetjen e dy auditimeve financiare pilot të KLSH.

Korniza e matjes së performancës kërkon adoptimin e Manualit të Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, në përputhje me ISSAI 200 dhe ISSAI 400. Këto manuale ne i kemi përkthyer dhe jemi përpjekur t’i implementojmë qysh në vitet 2012 e 2013. Në lidhje me këtë dimension, KLSH është vlerësuar se i përmbush pjesërisht 2-3 pikë, nga 4 kërkesat e përcaktuara sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Për auditimet financiare, KLSH përmbush plotësisht 20 nga 21 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi. Është vlerësuar si e përmbushur pjesërisht kërkesa për përcaktimin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi, nivelin e materialitetit ose nivelet që do të zbatohen për lloje të veçanta të transaksioneve, gjendjet e llogarive apo dhënien e informacioneve shpjeguese.

Për auditimet e përputhshmërisë, KLSH i përmbush plotësisht 11 nga 18 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi. Janë vlerësuar si të përmbushura pjesërisht, kërkesat në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të auditimit, të kuptuarit të mjedisit të kontrollit dhe kontrollet e brendshme përkatëse, si dhe ndërtimi i procedurave të përshtatshme të auditimit, që adresojnë nivelin e risqeve të identifikuara. KLSH ka vlerësuar si të pamjaftueshme

procedurat e kryera gjatë auditimeve të përputhshmërisë, në lidhje me identifikimin e risqeve të mashtrimit financiar, si dhe hartimit të strategjisë dhe planit të auditimit.

Për auditimet e performancës, KLSH përmbush plotësisht vetëm 6 nga 21 kërkesat e këtij dimension vlerësimi. Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesave, konstatohet se përmbushen në nivel pjesor.

Ky dimension kërkon krijimin nga SAI të një sistemi, për të siguruar që grupi i auditimit, si një i tërë, ka kompetencën dhe aftësitë e duhura për realizimin e misionit auditues:

Për auditimet financiare, KLSH ka plotësuar plotësisht 10 nga 11 kërkesat e përcaktuara në modulën e vlerësimit për auditimet financiare. Është vlerësuar si e përmbushur pjesërisht kërkesa për ekspertizën teknike, duke përfshirë ekspertizën e IT dhe fushat e specializuara të kontabilitetit ose auditimit. Përdorimi gjithnjë e më i gjerë i sistemeve IT në fushën e raportimit financiar në sektorin publik, kërkon që KLSH të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet në auditimin e këtyre sistemeve, në funksion të efektivitetit të auditimeve financiare.

Kontrolli i cilësisë

Po t' u referohemi kërkesave të lidhura me kontrollin e cilësisë në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, KLSH përmbush plotësisht kriteret e vlerësimit. ISSAI 40 kërkon që e gjithë puna e kryer duhet të jetë subjekt i rishqyrtimit, si një mjet për të kontribuar në cilësinë dhe nxitjen e të mësuarit dhe zhvillimit të personelit. Në këtë proces, përfshihet rishikimi i planit të auditimit, letrave të punës dhe punës së grupit, si dhe monitorimi i rregullt i ecursisë së auditimit nga nivelet e përshtatshme të menaxhimit. Shqyrtimi ndihmon KLSH-në për të siguruar se auditimi është kryer në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme, si dhe se raporti i audituesit me mjedisin është i përshtatshëm.

Në funksion të sigurimit mbi cilësinë e dosjeve, për auditimet e evaduara gjatë vitit 2017, me urdhrin nr. 12 të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 30.01.2018 “Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë”, është realizuar vlerësimi i sigurimit të cilësisë për 46 dosje, të cilat përbëjnë 30% të dosjeve të evaduara gjatë vitit 2017. Përzgjedhja u bë në mënyrë të rastësishme, duke prekur si auditimet financiare edhe ato të performancës, nga subjekte të institucioneve qendrore deri tek njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionere.

Procesi i vlerësimit ka përfshirë gjithë ciklin e procesit auditues, pra:

Planifikimi i auditimit/hartimi i programeve të auditimit, kryerja e auditimit, raportimi dhe evadimi i materialeve të auditimit.

Vlerësimi është bërë bazuar në 21 tregues, për secilën dosje me një pikëzim të përshkallëzuar nga 1, shumë mirë, në 4, jo mjaftueshëm, në këtë rast është vlerësim i brendshëm yni, referuar faktit nëse auditimi ka përmbushur kërkesat optimale të ligjit, të rregullores së brendshme dhe standardeve të auditimit.

Në përfundim të veprimtarisë së kontrollit të zbatimit të cilësisë, rezulton se puna audituese reflekton përmirësim të dukshëm, referuar kornizës rregullative të procesit auditues. Mbi 60 % e dosjeve të auditimit vlerësohen të mira, dhe vetëm 13 % janë vlerësuar mjaftueshëm.

Procesi i planifikimit.

KLSH plotëson pjesërisht kërkesat e lidhura me procesin e planifikimit, si për auditimin financiar, ashtu dhe atë të përputhshmërisë e të performancës. Përveç sfidave në lidhje me përcaktimin e materialitetit, në auditimin financiar dhe në vlerësimin e risqeve në auditimet e përputhshmërisë, KLSH-ja duhet të zhvillojë më tej procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të një strategjie të përgjithshme auditimi, që përfshin qëllimin, kohështirjen dhe drejtimin e auditimit. Në këtë strategji duhet përcaktuar natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të vlerësimit të riskut, si dhe natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të planifikuara të auditimit në nivelin e proceseve (*nuk kuptohet*) dhe të auditimit.

Deri tani KLSH-ja ka vijuar me program auditimi, por si pjesë e auditimeve pilot me SAI-n polak, po punohet për standardizimin dhe përfshirjen e strategjisë së auditimit edhe si pjesë e letrave të punës. Për më tepër KLSH-ja duhet të fokusohet që gjatë auditimeve financiare të identifikojë edhe risqet e anomalive materiale, si pasojë e mospërputhjes materiale me ligjet, rregullat dhe aspektet e përputhshmërisë, çështje kjo që po trajtohet si pjesë e auditimeve pilot me SAI-in polak.

Puna audituese.

Në lidhje me realizimin e procesit të realizimit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, si dhe të vlerësimit të evidencave të auditimit, KLSH-ja përmbush pjesërisht kërkesat e kriterëve të vlerësimit. Kryerja e auditimit në bazë risku është një prioritet i KLSH-së dhe një sfidë në vijim dhe për këtë jemi duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për planifikimin, ekzekutimin dhe raportimin në bazë të kësaj metode auditimi, duke garantuar që opinionin e auditimit të bazohet në evidenca të përshtatshme. KLSH-ja po lëviz gradualisht nga dokumentimi i vetëm i gjetjeve të auditimit, në dokumentimin e të

gjitha testimeve të kryera, ku duhet të përfshihen në të edhe evidencat e mjaftueshme të auditimit për të mbështetur konkluzionet e nxjerra, duke pasur parasysh edhe riskun e vlerësuar të anomalive materiale, si pasojë e mashtrimit financiar ose mashtrimit të dyshuar gjatë auditimit. Kjo, me qëllim që të sigurohemi se janë ndërmarrë të gjitha procedurat e planifikuara të auditimit, ose aty ku nuk janë ndërmarrë të gjitha procedurat e planifikuara, të jetë në dosjen e auditimit një shpjegim se pse nuk u kryen, i cili duhet të jetë i aprovuar nga personat përgjegjës për auditimin.

Objektivi do të quhet i përmbushur kur të gjitha dosjet e auditimit të përmbajnë dokumentimin e auditimit, që është i mjaftueshëm për t'i mundësuar një audituese me përvojë, pa njohuri paraprake të auditimit, të kuptojë natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të kryera të auditimit, rezultatet dhe evidencat e marra të auditimit.

Raportimi i rezultateve.

KLSH-ja është vlerësuar se i përmbush plotësisht kërkesat në lidhje me dorëzimin dhe publikimin në kohë të rezultateve të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në përputhje me praktikat më të mira sa herë duhet të krijojë një praktikë për vlerësimin e materialitetit, me qëllim përcaktimin se kur një procedurë e ndjekjes së rekomandimeve kërkon një auditim shtesë. Në tërësi, aktiviteti auditues i KLSH-së, në zbatim të standardeve të SAI-t, si dhe praktikave me të mira të të gjitha komuniteteve se SAI-it është vlerësuar dhe unë po citoj presidentin e Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Çekisë, inxhinierin Miloslav Kal, i cili është njëherazi edhe zëvendëspresident i EUROSAI. KLSH-ja në Shqipëri ka ndërmarrë reforma të mëdha të cilat e kanë përafruar me modelet dhe metodologjinë audituese europiane.

“Në Shqipëri keni arritur një standard të lartë si institucion shtetëror, kurse puna juaj ka shënuar impakte të rëndësishme për mirëqeverisjen në vend. Si president i SAI-t çek dhe si zëvendëspresident i EUROSAI, dëshiroj të konfirmoj vullnetin tim për të mbështetur KLSH-në në kapërcimin e sfidave që has në implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit”, është shprehur Presidenti i zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Çekisë, Kala.

Gjithashtu, përgjatë realizimit të aktivitetit auditues dhe më gjerë, KLSH-ja ka zbatuar me korrektësi dhe profesionalizëm rekomandimet e adresuara nga BE-ja në progresraportin e fundit. Pas çdo rezolute të Kuvendit të Shqipërisë dhe çdo rezolute të progresraportit të BE-së, siç jeni në dijeni, ne hartojmë një plan veprimi për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në adresë të KLSH-së. Rekomandimi i progresraportit është që

KLSH-ja të rrisë numrin e auditimeve pilot financiar të përputhshmërisë, të rregullshmërisë në përputhje me manualët e përditësuar dhe standardet e auditimit. Në këtë drejtim, gjatë këtij viti, objektivat e vëna nga *DG Budget* i kemi tejkaluar si numër auditimesh. Auditimet e performancës në këta 6 vjet janë parë dhe do të vijojnë të shihen si një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Sfida më e madhe për këtë lloj auditimi është që ai të mos zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe të vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së, një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por, në radhë të parë, një instrument parandalimi, korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet.

Zhvillimi i auditimeve ka qenë në linjë dhe në përputhje të plotë me objektivat e planit strategjik 2013-2017 të KLSH-së. Gjatë vitit 2017 janë realizuar 15 auditime performance në reformat qeveritare, në aspekte të rëndësishme të financave publike, në sistemin e prokurimit publik, në sistemin arsimor, në projektet mjedisore, si dhe në shërbimet publike. Për vitin 2018 ne po vazhdojmë një bashkëpunim intensiv me USAID-in, përmes një projekti për të cilin ne jemi besimplotë që do të rrisë ndjeshëm efektivitetin e auditimeve tona dhe transparencën në këtë sistem.

Vlerësimi i dimensionit, aftësitë dhe menaxhimi i grupit të auditimit të performancës në KLSH kanë dëshmuar një nivel të qëndrueshëm të tij.

Grupet audituese në auditimet e performancës, për shkak të vetë natyrës së këtij auditimi, kompozohen të tilla që të mbulojnë fusha të ndryshme profesionale ekonomike, juridike dhe sociale. Synimi në këtë drejtim ka qenë krijimi i një bërthame grupesh të qëndrueshme auditimi me kolegë, të cilët plotësojnë njohuritë dhe eksperiencat e njeri-tjetrit.

d) Fusha, menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse.

Kjo fushë mbështetet mbi një tregues i SAI-t, treguesi 21, menaxhimi financiar, asetet dhe shërbimet mbështetëse, i cili në këto dimensione është menaxhimi financiar, planifikimi dhe përdorimi efektiv i aseteve dhe infrastrukturës, si dhe shërbimet administrative mbështetëse. Vlerësimi i kësaj fushe tregoi se KLSH-ja ka një menaxhim organizativ të përshtatshëm dhe struktura mbështetëse, që sigurojnë një qeverisje të mirë dhe mbështetin kontrollin e brendshëm dhe praktikatat e menaxhimit në përputhje me kërkesat e ISSAI 12, parimi 9. Kjo gjetje është gjithëpërfshirëse si për menaxhimin e aseteve, ashtu dhe të shërbimeve mbështetëse të institucionit. KLSH-ja në zbatim të ISSAI 20 ka menaxhuar transaksionet e tij me ekonomicitet dhe efektivitet, si dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloren. Sistemi i vlerësimit të performancës në lidhje me dimensionin e planifikimit dhe

përdorimit të aseteve dhe infrastrukturës, tregoi se duhet përmirësuar planifikimi afatgjatë për nevojat e infrastrukturës në përputhje me objektivat strategjikë të zhvillimit institucional.

Buxheti i akorduar për veprimtarinë audituese të KLSH-së ka në bazë të tij deklaratën e politikës së programit të hartuar gjatë procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm 2017-2019. Ai është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në dokumentin themelor të zhvillimit institucional, që ishte strategjia e zhvillimit të KLSH-së 2013-2017. Politika buxhetore e këtij programi ka synuar përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të objektivave prioriteteve të institucionit, të parashikuara në planin e zhvillimit strategjik 2013-2017, duke marrë në konsideratë kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE, të monitoruara nga *DG Budget* në kuadrin e integritetit europian.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të KLSH-së, sipas programit 2013-2017 dhe niveli i realizimit të tyre, paraqiten në mënyrë të detajuar në aneks të veçantë në këtë raport vjetor performance. Gjatë vitit 2017, në respektim të planit të veprimtarisë audituese, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka kryer auditimin e rregullshmërisë financiare të aktivitetit ekonomiko-financiar të KLSH-së për periudhën nga 1 janar 2017 deri në 31 dhjetor 2017.

Ne jemi në pritje dhe shpresojmë që, mbështetur në kërkesat tona të vazhdueshme dhe në vendimin që Kuvendi i Shqipërisë ka marrë nga kërkesa e Komisionit të Ekonomisë, Kuvendi të përcaktojë grupin e punës për auditimin e llogarive financiare të KLSH-së, gjë që do të jetë një hap më tepër në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies publike të institucionit tonë, duke i dhënë përgjigje edhe asaj pyetje klasike që shtrohet në auditimin e jashtëm publik “Po audituesin kush e auditon?”

Gjatë vitit 2017 u realizua ngritja e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në ambientin e godinës së re, si dhe investimi e krijimi e një sistemi informacioni për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve të auditimit në KLSH. Ky investim realizoi një sistem elektronik për administrimin e KLSH-së nëpërmjet menaxhimit të aktivitetit, të çështjeve, të proceseve, dhe të raportimeve në një platforme *software* të integruar, në përputhje me manualin dhe rregulloren në fuqi në lidhje me disponibilitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit. Nëpërmjet këtij investimi është synuar optimizimi i procesit të auditimit, duke respektuar parimet mbi të cilat ai mbështetet, rritja e eficiencës me anë të sigurimit të kontekstit të plotë të rastit për audituesin, përmirësimi i performancës, produktivitetit dhe eficiencës operationale të brendshme, përmirësimi i monitorimit dhe

rritjes së eficiencës së administrimit të çështjeve, përmirësimi dhe garantimi i transparencës dhe monitorimit të aktivitetit të organizatës sonë në zbatim të objektivave etj.

Zbatimi nga ana jonë i sistemit **ref zone** do ta ngrejë punën audituese të KLSH-së në një stad më të lartë për sa i përket modernizimit. Domethënë, në masën më të madhe, kontrolli dhe monitorimi i kësaj punë, në veçanti nga menaxhimi, do të kryhen përmes procedurave të informatizuara.

Për sa i përket ndërtesës së re në të cilën KLSH-ja është vendosur në fillimin e vitit 2018, unë, si kryetar i KLSH-së, dhe stafi, të ndërgjegjshëm për këta arritje, falënderojmë në këtë seancë Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit dhe qeverinë e Republikës së Shqipërisë për disponibilitetin dhe vullnetin pozitiv të treguar për akordimin e fondeve dhe mbështetjen e KLSH-së lidhur me komponentin e infrastrukturës, ambienteve të punës dhe teknologjisë së informacionit. Por dua të sjell në vëmendje se nevojat për fondet financiare ende janë të pamjaftueshme, sidomos ato lidhur me koston e punës dhe të kontraktimit të ekspertëve të jashtëm, kosto të cilat do të bëjnë të mundur plotësimin e kërkesave nga ekzekutivi për mbulim me auditim të të gjitha njësive të qeverisjes vendore, çka është kërkuar në ligj, apo auditimin e koncesioneve dhe privatizimeve si kërkesë e Komisionit të Ekonomisë. Mbështetur edhe në korrespondencën 5 mujore që kam me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe me ministrin e Financave, besoj se Kuvendi do t'i japë zgjidhje këtij problemi, të paktën për këtë periudhë 6-mujore të mbetur, me qëllim që ne të kemi mundësi të shpërblejmë punonjësit dhe drejtuesit tanë në të gjithë administratën shtetërore, sipas punës dhe nivelit arsimor dhe profesional, por edhe të rekrutojmë ekspertë të jashtëm, që janë të nevojshëm për auditime cilësore dhe me efektivitet.

Kujtoj këtu, dhe do ta përmend edhe më vonë, që në KLSH në këto momente janë të paktën 8 vetë me gradën shkencore “Doktor i shkencave”. Kemi një profesor-doktor, zonjën Lati, profesor të asociuar, drejtoreshën tjetër të Përgjithshme, zonjën Laço dhe disa drejtues me certifikata ndërkombëtare auditimi.

Fusha E. Burimet njerëzore dhe trajnimi.

Ky aspekt i vlerësimit të aktivitetit është bazuar në ISSAI-n 40, si dhe në udhëzuesin e Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI-t, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore, kuadrin institucional të ndërtimit të kapaciteteve. Kjo fushë tregon performancën e KLSH-së në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe është ndërtuar mbi bazën e dy treguesve: menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin, trajnimin profesional, të cilat kanë 3 dhe 4 dimensione.

Menaxhimi i burimeve njerëzore në KLSH është konsideruar si parakusht jetik për funksionimin e institucionit në mënyrë efikase. KLSH-ja, në kuadrin e reformimit dhe modernizimit institucional, ka zbatuar në vijimësi politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila është në një linjë me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit dhe me parimet e praktikave më të mira të administratës publike të rekomanduara nga BE-ja. Në bashkëpunim me ekspertët e NIK-ut polak, në kuadër të projektit IPA, gjatë vitit 2017, ne punuam dhe në fund të vitit finalizuam dokumentin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, dokument i cili bën një pasqyrë të plotë të procesit të rekrutimeve në KLSH në këto vite, resurset dhe burimet njerëzore, që kemi në tërësi, por edhe perspektivat tona si e konceptojmë ne këtë problem tangencialisht. Unë do të jap disa të dhëna.

Ju lutem, kalojeni tek ato grafikët që flasin për treguesit e moshës dhe raportet gjinore!

Falë ndihmës së Komisionit të Ekonomisë dhe këtë nuk e theksoj këtu, se nuk kam nevojë t'i bëj qejfin ndokujt, të paktën në jetë nuk e kam pasur, dhe në çdo takim që kam me ndërkombëtarë, ne kemi arritur që çdo vit, që nga viti 2012, në KLSH të shtohen 5 auditues dhe kjo në harkun kohor të 6 vjetëve. Është një numër relativisht i konsiderueshëm, që garanton atë transfuzion të nevojshëm, atë transformim që ne në KLSH e kemi zhvilluar pa shumë bujë, duke mos penguar punën tonë audituese. Në vitin 2017 ne kishim në total 181 punonjës, nga të cilët 156 kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në veprimtari audituese. Kujtoj këtu që në këto vjet kemi krijuar Departamentin e Përformancës, i cili është një departament i ri dhe drejtohet nga një doktor i shkencave ekonomike dhe personalitet në fushën e tij. Ai është një departament i cili ende ka nevojë për auditues të rinj dhe të mirëshkolluar. Gjithashtu, kemi krijuar Drejtorinë Auditimeve IT, e cila drejtohet nga një audituese me përvojë 20-vjeçare në institucionin tonë.

Duhet të theksoj këtu që rritja në numër e audituesve, duke mos pasur ndryshime të qenësishme në fondet në dispozicion të KLSH-së ka sjellë një reduktim të ekspertëve të jashtëm të kontraktuar nga KLSH-ja. Ata përfaqësonin personalitete me kontribute të njohura në fusha dhe disiplinat përkatëse, por edhe ish-auditues me përvojë. Ne, në këtë drejtim, kemi nevojë për mbështetjen tuaj që të bëjmë një përmirësim në këtë 6 muaj. Profesione kryesore të stafit auditues janë financierë dhe juristë, megjithatë ne kemi dhe shumë audituese me dy diploma. Mbështetur në politikat e realizuara gjatë këtyre vjetëve ne në KLSH kemi arritur që moshën mesatare nga 50 vjeç, që ishte në KLSH në fund të vitit 2011, kur unë fillova detyrën

(nga të cilët 25% ishin në prag pensioni), ta ulim në 42.9 vjeç. Në rast se do të shihni grafikun e paraqitur në monitor, tregon seriozitetin tonë në këtë drejtim.

Pra, tashmë ne kemi një institucion me një moshë mesatare kur njeriu është në kulmin të aktiviteteve të tij njerëzore dhe profesionale. Profesioni i auditimit është një profesion shumë i lodhshëm. Nga ana tjetër, për sa u përket politikave të barazisë gjinore të ndjekura prej meje në këto vite, në rast se në vitin 2011 raporti mes audituesëve dhe audituesve ishte 33% me 67%, ne tani e kemi kaluar dhe ky raport është 40% me 60%, pra 40% janë audituese femra. Objektivi ynë për vitin 2019, si institucion, dhe për këtë kemi politika të qarta (besoj se do ta arrijë edhe ai që do të vijë pas meje), është të kemi paritet të plotë, të jenë 50 me 50 ky raport me KLSH-në.

KLSH-ja ka zbatuar politika efektive të menaxhimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore bazuar në 3 parimet bazë: vlerësimin e profesionalizmit, të transparencës, konkurrimi i hapur dhe mundësia e pjesëmarrjes për të gjithë të interesuarit. Nga ana tjetër, ne vlerësojmë maksimalisht dhe kontrollojmë procedurën 1-vjeçare të periudhës së provës dhe ata auditues, që nuk përmbushin pritshmëritë, mbështetur mbi procedurat e transparencës të dhënies së provimit, me apo pa keqardhje, largohen nga KLSH-ja.

Gjatë vitit 2017 në KLSH janë rekrutuar 22 audituese dhe drejtues nga të cilët një drejtues me titullin profesor-doktor, zonja Lati, dy drejtues me diplomë ndërkombëtare në kontabilitet dhe auditim dhe një audituese me titullin doktor i shkencave. Në tërësi, në këta 6 vjet në KLSH, nga zero që ka qenë ky numër, sot janë 8 drejtues, 2 prej të cilëve janë profesor dhe profesor i asociuar, kurse të tjerët doktor i shkencave, 19 drejtues dhe audituese kanë një diplomë të dytë nga të cilët 14 në drejtësi dhe 5 në financë. 5 drejtues dhe audituese kanë certifikatë ndërkombëtare në kontabilitet dhe auditim CIPFA dhe certifikatë ndërkombëtare në auditim CPA. Sistemi i zhvillimit, për sa i përket fushës së burimeve njerëzore dhe trajnimit, treguesi tjetër 23, sistemi i Zhvillimit Profesional, i cili është dimension i parë që përcakton ky tregues, reflekton efektivitetin e politikave të rritjes së kapaciteteve profesionale të KLSH-së. Në qoftë se shihni grafikun në tabelë, nga 2-3 ditë trajnimi, që ishin në vitet 2010-2011, nga viti 2012 në KLSH zhvillohen 20-28,5 ditë trajnimi në vit. Për vitin 2017, ne kemi zhvilluar 28,5 ditë trajnimi në vit dhe për këtë jemi vlerësuar nga komuniteti INTOSAI dhe EUROSAI si një nga SAI-et me treguesin më të lartë. Për institucionin tonë rekomandohen 15-25 ditë trajnimi në vit, por i ndërgjegjshëm dhe për të ngulitur filozofinë e të mësuarit për gjatë gjithë jetës, unë e kam orientuar KLSH-në, duke zhvilluar këto trajnime, të cilat i kemi shpërndarë në trajnime të brendshme 52%, një pjesë e

vogël është e-learning (përmes internetit), trajnime me ekspertë të huaj në vend 19% dhe trajnime jashtë shtetit 27%. Theksoj se në trajnimet jashtë shtetit pjesa më e madhe janë realizuar ndërmjet projekteve me institucionet supreme të auditimit simotra europiane, por që udhëtimi i audituesve mbështetet nga burimet tona financiare, gjithmonë duke mos pasur rritje të konsiderueshme me shpenzimet operative që ne kemi pasur për diçka në vitet 2010-2011.

Gjithashtu, dua të theksoj se 10 auditues të KLSH-së kanë përfutur trajnime nëpërmjet intershipeve me afat 5-mujor nga Gjykata Europiane e Audituesve në Luksemburg dhe 5 të tjerë kanë përfutur trajnime në institucionet supreme të auditimit në SHBA, GAO amerikane, e cila është lider në këtë fushë. Domethënë, nga një tregues drejt zeros në vitet e mëparshme, fakti që ne sot kemi arritur të kemi mbi 20 drejtues dhe auditues të trajnuar në GAO në një periudhë 4-mujore, flet shumë. Për këtë drejtoresha e Qendrës për Ekselencë në Auditim të GAO-s, zonja Laurent, thekson: “Vlerësoj fleksibilitetin e KLSH-së në përcaktimin e numrit dhe llojeve të auditimeve që do të realizohen, e cila është esenciale për veprimtarinë e një institucioni suprem auditimi. Një indikator i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve audituese është programi i trajnimeve”. Në këtë fushë, KLSH-ja ka krijuar një traditë solide, për të cilën GAO jep kontributin e saj përmes fellowship-eve për audituesit shqiptarë. Megjithatë, sistemi i matjes së performancës në këtë dimension identifikoi aspekte që duhet të përmirësohen më tej, si: strategjia e të mësuarit dhe plani vjetor për zhvillimin profesional dhe trajnimin të jenë në përputhje me strategjinë e burimeve njerëzore, të lidhur me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në planet strategjike dhe operacionale të KLSH-së, si dhe të jenë të bazuar në rezultatet e analizës së nevojave për të mësuar”.

Fusha 6 dhe e fundit “Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit”...

Erion Braçe – Më fal! Ju kërkoj ndjesë që po ju ndërpres fjalën, por a mund të përshpejtoni, në mënyrë që edhe deputetët të kenë kohë të bëjnë pyetjet e tyre lidhur me raportimin?

Bujar Leskaj – Unë po përshpejtoj, por kam diçka. Meqenëse deputetët nuk morën pjesë në forumin që ne organizuam me SIGMA-n, program i BE-së, një forum shumë i rëndësishëm, partnerët ndërkombëtarë më kërkuan që materialin, të cilin jua përcolla juve si kryetar, ta lexoj përpara deputetëve, sepse vetëm zoti Angjeli...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, më kërkuan ata ta deklamoj në komision.

Erion Braçe – Dakord, të përshpejtojmë, me qëllim që deputetët të kenë mundësi të bëjnë pyetjet dhe ju t’u përgjigjeni. Ju lutem!

Bujar Leskaj- A mund t’i lëmë pyetjet për një ditë tjetër, që të jetë edhe pjesa tjetër e komisionit, e cila shkëlqeu me mungesë?

Erion Braçe –Po erdhi pjesa tjetër, ju nuk do të keni mundësi të flisni.

Bujar Leskaj- Pse?

Erion Braçe- S’të lënë.

Bujar Leskaj – Jo, zoti kryetar, ty dhe mua nuk na pengon njeri. Unë personalisht u referohem neneve 162 dhe 164 të Kushtetutës.

Erion Braçe – Dakord, vazhdo!

Bujar Leskaj – Të nderuar deputetë, qytetarë, media dhe gazetarë, ju kërkoj ndjesë, sepse duket sikur është një raport që ne flasim dhe deklamojmë vetë arritjet tona, por ne jemi përpjekur dhe vazhdimisht zhvillojmë analizën *suot* në institucion dhe gjatë raportit kam theksuar edhe mangësitë, edhe dobësitë e institucionit.

Që në fillim e thashë që ne krahasohemi me simotrat europiane, ku jemi në një nivel mesatar dhe këta nuk janë tregues që...

Jam i hapur për pyetjet dhe kërkesën e llogarisë nga ju dhe nuk pres ndonjë fletë lavdërimi as nga ju dhe as nga opozita. Unë jam shumë i kthjellët për të tashmen dhe të ardhmen time. Këta tregues janë një metodë inovative.

Ne kemi dy vjet që punojmë në KLSH dhe ne ishim të parët që e përqaftuam këtë dokument kur ishte në fazën e draftit. Këto dokumente për vite me radhë u liheshin SAI-ve në dëshirë të tyre. Si dokument zyrtar, ky është miratuar në kongres në dhjetor të vitit 2016 dhe u është lënë prapë një kohë e lirë, sepse janë ata SAI-et moderne që e aplikojnë këtë standard të matjes së performancës dhe ne synojmë që t’i arrijmë ato. Unë jam i bindur se vitin që vjen kjo paraqitje do të jetë më e mirë, ndoshta edhe unë personalisht do të kem mundësi të bëj kërkesë zyrtare te komisioni që në fund të mandatit tim të paraqes një kornizë të matjes së performancës së SAI-ve në këta 7 vjet të drejtimit të KLSH-së. Gjatë kësaj periudhe do të përpiqemi që këtë ta kemi përmes një procesi *pereview* nga institucionet ndërkombëtare të auditimit, domethënë nga një institucion modern europian i vendeve të BE-së, i cili të certifikojë arritjet dhe mosarritjet tona.

Për sa i përket fushës së komunikimit dhe menaxhimit të palëve të interesit, ne kemi shumë të reja në këtë drejtim. Motoja e kongresit të parafundit të EUROSAI-t ishte: Cila është hera e fundit që keni bërë një gjë për herë të parë? Kjo për të ngacmuar procesin

inovativ. Disa nga këto çështje janë trajtuar për herë të parë. Unë nuk po vazhdoj me materialin e përgatitur, sepse do të kem mundësi të plotësoj.

Ne në këto vite, falë bashkëpunimit me kryetarin, sekretarin e Komisionit dhe me të gjithë deputetët e pozitës dhe opozitës kemi shtuar informacionin dhe paraqitjen tonë te Komisioni i Ekonomisë. Në qoftë se para vitit 2011, për këtë jemi të ndërgjegjshëm ne dhe qytetarët shqiptarë, Kontrolli i Lartë i Shtetit vinte vetëm me dy paraqitje skematike për sa i përket raportit të performancës dhe raportit të buxhetit faktik të vitit paraardhës, që ishin detyrime kushtetuese, ne tani vijmë disa herë në Komisionin e Ekonomisë.

Së dyti, nëse para disa vitesh, ndoshta deri në vitin 2013, ne përcillnim një numër të kufizuar dhe një numër minimal të raporteve tona të auditimit te Komisioni i Ekonomisë, ne në vitin 2017 kemi përcjellë 24 raporte auditimi, gjithashtu kemi përcjellë edhe shkresa të ndryshme problematike. Këto shkresa ne i përcjellim te Kryetari i Kuvendit, te dy nënkryetarët e Kuvendit, që respektivisht përfaqësojnë pozitën dhe opozitën dhe te kryetari i Komisionit të Ekonomisë, të cilin e konsiderojmë parterin tonë kryesor në politikën shqiptare.

Së treti, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe audituesit tanë janë futur me guxim dhe me modesti në shtypin e përditshëm. Në vitin 2017, në shtypin e përditshëm audituesit tanë janë në 125 artikuj, analiza dhe opinione, ku ata ngrenë problematika për mirëmenaxhimin e financave publike, por ngrenë problematika dhe trajtojnë probleme të konstatuar gjatë auditimeve apo të KLSH-së.

Po ta shikoni grafikun që zoti Kondakçi paraqiti në tabelë, ky proces fillon nga viti 2013, ku ne kishim 58 shkrime, por që më parapara ka qenë një numër njëshifror 1,2,3,4 ose 5. Ne bëmë një provë në vitin 2012 dhe paraqitëm vetëm shkrimet e kryetarit, por, kur pamë që kishte interes nga qytetarët shqiptarë, ne vazhduam të botojmë në të gjitha gazetatat në Shqipëri. Këtu gjej rastin të falënderoj të gjithë kryeredaktorët e gazetave, gazetarët që mbulojnë problemet e ekonomisë dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit specifikisht, por edhe pronarët që na kanë krijuar këtë mundësi.

Për sa u përket botimeve tona, ne kemi një ecuri të mirë, e cila është për t'u lavdëruar. Këto botime dhe shkrime në gazeta ne i përmbledhim edhe në botime të veçanta tek "Audituesit shqiptarë në shtypin e përditshëm".

Së katërti, në këto vite ne kemi krijuar kulturën e botimit. Në qoftë se në Kontrollin e Lartë të Shtetit gjatë periudhës 20-vjeçare 1991-2011 ka pasur 12 botime modeste, të llojit broshura dhe dy përkthime, sot, në një periudhë 6-vjeçare kemi 83 botime, të cilat janë të standardeve ndërkombëtare.

Në vitin 2017 kemi realizuar 16 botime, titujt e të cilave kalojnë nga standardet ndërkombëtare. Botimet që ne kemi realizuar janë: “Auditimi publik”, ku në të majtë të saj është Korniza e Matjes së Performancës së SAI-eve; “40 vjet Deklarata e Limës 1977-2017”, e cila është kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit; “Auditimet e performancës”; “Gjykata Europiane e Auditimit, 40 vjet Auditim Publik”, e cila është një revistë shkencore, modeste, sepse ne në Shqipëri nuk kemi se çfarë të shtojmë, pasi gjërat e mençura i kanë thënë të tjerët, por ne duhet vetëm të implementojmë. Në qoftë se duam të përkthejmë, të përshtatim ose të implementojmë në institucion, standardet ndërkombëtare të auditimit janë miniera ari. Këto 16 botime i kemi realizuar me një buxhet modest, shifrën e të cilit e raportojmë. Një botim me një tirazh 250-300 kopje, shkon 130 mijë lekë të rinj për botim, që do të thotë se është një tregues minimal.

Së pesti, gjatë viteve 2009-2011 trajtohej një numër i kufizuar letrash, statistikave tregojnë se numri i letrave që trajtoheshin ishte 30-60 letra, ndërsa gjatë vitit 2017 ne kemi trajtuar 650 letra, 200 prej tyre janë jashtë juridiksionit tonë, ku 150-170 prej tyre u kemi dhënë drejtim, ndërsa 173 të tjera i kemi në proces verifikimi. Ne kemi krijuar një traditë në këtë fushë, e cila mendoj se duhet të ndiqet edhe nga institucionet e tjera shqiptare, sepse është detyrim t’u përgjigjesh shqiptarëve, forcon llogaridhënien dhe transparencën. Nuk më kujtohet shprehja, por po e përmbledh kështu: “E shkruara mbetet, fjalët i merr era”, korrespondenca me shkrim, sidomos në zgjidhjen e problemeve për qytetarët është shumë e rëndësishme. Përveç kësaj, gjatë vitit 2017 ne kemi zbatuar tërësisht ligjin për të drejtën e informimit, duke i përcjellë raportet tona edhe në institucionet që i kanë kërkuar, si: Qendra për Transparencë dhe Informim; Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim; Instituti i Studimeve Politike; Instituti Shqiptar i Shkencës, qendra “ResPublica” e të tjerë. Këto raporte kanë forcuar transparencën, llogaridhënien dhe përpjekjet tona në këtë drejtim. Ne jemi kujdesur të mos cenojmë partnerët tanë dhe subjektet që ne auditojmë, megjithëse unë them se ai ligj duhet të përmirësohet, sepse qytetarët shqiptarë duhet t’i dinë me emra dhe mbiemra dhe jo me iniciale ata që abuzojnë me pronën publike, ata që përfitojnë nga fondet publike e të tjerë. Ne nuk kemi pse të cenojmë të drejtën e informimit nën petkun e ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe privatësisë.

Ne kemi këtu tregues, të cilët ju i keni te doracaku që unë kam përcjellë, pra që ne kemi përgatitur për ju. Ju kërkoj ndjesë që përdora fjalën “unë”, sepse ne punojmë si ekip. Ne kemi përcjellë edhe raportet tona në medie si ka evoluar nga viti në vit. Prezenca në medie e

KLSH-së dhe ato që shkruajnë mediet për KLSH-në janë risitë që ne kemi në fushën e komunikimit.

Ne për vite me radhë kemi organizuar javën e hapur të KLSH-së, në vitin 2017 kemi realizuar, gjatë muajit nëntor, muajin e hapur të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai ishte një muaj gjatë të cilit ne zhvilluam 49 veprimtari, ku ftuam personalitete, dhamë leksione për studentët, hapëm dyert për qytetarët, për publikun e interesuar e më gjerë. Ne jemi të fokusuar, por besoj se edhe me ndihmën tuaj, dhe do të vazhdojmë të rrisim treguesit tanë për sa i përket zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, e cila është një kërkesë e përhershme e BE-së. Në disa tregues ne kemi përmirësime, por për sa i përket ndëshkimit të zyrtarëve të lartë, jemi dobët.

Gjithashtu, në fund të fjalës sime, më lejoni të përsëris, ne insistojmë në kërkesën që kemi bërë para 5 vjetësh, që në Shqipëri duhet të hartohet ligji për përgjegjësinë materiale të zyrtarëve të lartë. Dua të përsëri një thënien time, të cilën e kam lançuar edhe në aktivitete të tjera: duke mbështetur tërësisht reformën në drejtësi, duhet të jemi të ndërgjegjshëm që reforma në drejtësi është kushti i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe të pasurive publike. Që reforma e drejtësisë të jetë efiçiente, paralelisht me punën që bëjnë institucionet e vetingut, ne duhet të vazhdojmë të plotësojnë kornizën tonë ligjore dhe pjesa jonë e përbashkët e Komisioni i Ekonomisë, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministria e Financave, të përmbushim detyrimet për një menaxhim të mirë financiar të financave publike të Shqipërisë, por edhe të pasurisë publike.

Si përfundim, dua të them diçka në mënyrë simbolike, ne kemi bërë një varkë të thjeshtë, e cila udhëhiqet nga parimet e Kuvendit, si: llogaridhënia, kontrolli i qeverisë, zbatimi i rekomandimeve, dhe nga tetë parimet tona, që janë: profesionalizmi, integriteti, objektiviteti, përgjegjshmëria, bashkëpunimi, transparenca, pavarësia. Do të ishte shumë mirë që nga varkë të kalojë në një mjet motorik më të fuqishëm!

Erion Braçe – Do të ishte më mirë të jemi modestë sesa me këto lloj mjete, sepse identifikohemi ndryshe pastaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bujar Leskaj - Jo, them të gjithë bashkë: Kuvendi, KLSH-ja, qeveria dhe opozita. Shikoni, aty ka vend për të gjithë!

Erion Braçe – Pa merak!

Bujar Leskaj – Ne jemi përpjekur në mënyrë simbolike, kemi dhënë dy institucionet tona, por kuptohet se në atë varkë është e gjithë Shqipëria, janë të gjithë institucionet: qeveria, opozita dhe ne të tjerët.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj, kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për ekspozenë e gjerë dhe të gjatë, por edhe për faktin që na përcolli këtu këshillat që i kishin dhënë përfaqësuesit e Këshillit European! Dua t’ju heq një merak, atë material na e ka përcjellë kryetari, dhe dua që t’ia përcillni këtë mesazh edhe atyre që u kanë thënë se duhet të na i lexoni, deputetët dinë të lexojnë!

Për pjesën e raportit për veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të mundohem të jem sa më koncize, duke përmbledhur vlerësimin e punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2017, gjithashtu edhe sugjerimet në vazhden e vitit 2018.

Shqyrtimi i raportit për veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin e mëparshëm përbën një ndër ngjarjet më të rëndësishme të veprimtarisë së Kuvendit për shkak të rolit të tij, si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm, që informon Kuvendin, palët e interesuara dhe publikun për mënyrën e administrimit të fondeve publike.

Raportimi vjetor i veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit kryhet në përputhje me kërkesat e nenit 164 të Kushtetutës, nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 103 të Rregullores së Kuvendit.

Veprimtaria e KLSH-së paraqitet nëpërmjet një raporti të zgjeruar, në të cilin pasqyrohen informacione të detajuara mbi veprimtarinë audituese të institucionit, komunikimin dhe bashkëpunimin e tij me grupet e interesit, si dhe menaxhimin institucional dhe zhvillimin strategjik. Lidhur me veprimtarinë audituese, raporti përmban fakte dhe statistika, dinamikën e auditimeve, sipas fushave kryesore, si dhe raportime mbi auditimin e performancës dhe të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Për sa i përket vlerësimit të përgjithshëm,

mbështetur në raportin e paraqitur nga KLSH-ja, si dhe në vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, vlerësimi i përgjithshëm është se Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2017, ka realizuar misionin e tij kushtetues dhe ligjor, duke informuar Kuvendin, palët e interesit dhe qytetarët, në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi

përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e fondeve publike. Ky informim ka kontribuar në thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimin e qeverisjes.

Realizimi i misionit është një hap i rëndësishëm drejt vizionit të tij, si një institucion që nxit përgjegjshmërinë dhe transparencën në drejtim të përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të pasurisë publike, duke forcuar integritetin e institucionit dhe duke rritur besimin e publikut.

Për sa u përket vlerësimi nga institucionet ndërkombëtare,

veprimtaria e KLSH-së është vlerësuar nga institucionet mbikëqyrëse ndërkombëtare, nga programi SIGMA-OECD i Bashkimit Europian dhe Banka Botërore, si një faktor përcaktues për rritjen e përgjegjshmërisë në përdorimin e parasë publike. Në veprimtarinë e saj KLSH-ja është mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit, si dhe në parimet e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t.

Kompetencat e veprimtarisë audituese të KLSH-së

Sipas nenit 10 të ligjit organik të institucionit, KLSH-ja ka për kompetencë:

a) auditimin e zbatimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë llogaritë vjetore të buxhetit;

b) auditimin e mbledhjes së të ardhurave publike;

c) auditimin e përdorimit, administrimit dhe mbrojtjes së fondeve publike dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

ç) auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e opinionit për to;

d) auditimin e sistemeve të auditimit të brendshëm të sektorit publik;

dh) auditimin e përdoruesve të fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Europian ose organizata të tjera ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe me ligj të veçantë;

e) auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike dhe financiarë të Shtetit në personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesës së aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;

ë) auditimin, me qëllim mbrojtjen e interesave publikë në veprimtaritë apo sektorët e rregulluar me kontrata koncesionare;

f) auditimin e partive politike, enteve publike apo shoqatave për fondet që u janë akorduar atyre nga buxheti i shtetit;

g) auditimin e subjekteve të tjera, të përcaktuara në ligje të veçanta.

Së dyti, Kontrolli i Lartë i Shtetit, çdo vit jep opinion për raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar.

Për sa i përket vlerësimit të punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017, veprimtaria e KLSH-së, gjatë vitit 2017, është fokusuar në tri drejtime kryesore:

Së pari, në veprimtarinë audituese.

Së dyti, në komunikimin dhe bashkëpunimin me palët e interesit.

Së treti, në menaxhimin institucional dhe zhvillimin strategjik.

Vlerësimi i kësaj veprimtarie mbështetet në kërkesat kushtetuese dhe ligjore, strategjinë e zhvillimit të institucionit, në raportin e paraqitur nga KLSH-ja, rekomandimet e dhëna në rezolutat e viteve të fundit të Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit, si dhe vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare.

Bazuar në këto dokumente, për veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2017, paraqes vlerësimin si më poshtë:

1. Veprimtaria audituese e KLSH-së është zgjeruar krahasuar më një vit më parë, si në drejtim të numrit të auditimeve, po ashtu edhe të numrit të institucioneve të audituara.

Gjatë vitit 2017 janë kryer 156 auditime, nga 150 auditime të planifikuara dhe 154 auditime të realizuara një vit më parë. Gjithashtu, është rritur numri i institucioneve të audituara, i cili është 266, nga 259, që ishte një vit më parë.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar harmonizimin e formave të ndryshme të auditimit, duke i dhënë përparësi rritjes së peshës së auditimeve financiare, auditimeve të performancës dhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Në këtë mënyrë, KLSH-ja ka vënë në zbatim rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të vitit 2016, si dhe rekomandimet e BE-së, SIGMA-s dhe standardet e INTOSAI-t. Peshën kryesore të auditimit vijnë ta kenë auditimet financiare.

3. Në auditimin e performancës u realizuan objektivat e parashikuar, si: rritja e numrit të auditimeve; rritja e numrit të subjekteve të mbuluara me këtë lloj auditimi; rritja e numrit të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo auditim; rritja e rolit këshillues dhe rekomandues të KLSH-së; zbatimi i akteve rregullatore, duke sjellë përmirësimin e cilësisë së auditimit.

Megjithatë, auditimet e performancës zënë ende një peshë të vogël në veprimtarinë audituese. Ato përfaqësojnë mesatarisht 10%-12% të punës audituese vjetore, nga 50%, që janë në SAI-t e zhvilluara. Edhe cilësia e auditimeve të performancës duhet të përmirësohet më tej, duke thelluar analizën e riskut, njohur më mirë standardet ndërkombëtare të auditivit duke rritur kapacitetet profesionale të audituesve e të tjerë.

4. KLSH-ja ka realizuar rekomandimet për ngritjen dhe konsolidimin e auditimeve të sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke realizuar 5 auditime nga 4 të planifikuara, e cila ka sjellë rritjen e mbulimit me këtë lloj auditimi.

Konsolidimi i këtij auditimi specifik mbetet ende një sfidë për KLSH-në, si një kërkesë e kohës.

5. KLSH-ja ka vijuar punën për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit. Kjo vërehet në këto drejtime:

a) Gjatë auditimit KLSH-ja ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, me një dëm efektiv të përgjithshëm në shumën rreth 110,5 miliardë lekë, nga të cilat 11,5 miliardë lekë janë parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit; 99 miliardë lekë janë shkelje të disiplinës financiare, me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara.

Edhe këtë vit shkeljet më të mëdha janë në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik. Kjo tregon se është e nevojshme të rritet përgjegjshmëria menaxheriale për të garantuar një sistem menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efektiv.

b) Për çdo lekë të shpenzuar për KLSH-në, janë zbuluar dhe kërkuar për t'u zhdëmtuar 31,9 lekë. Për vitet 2012-2017 rezulton se për çdo lekë të shpenzuar për institucionin e KLSH-së, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 108,7 lekë, ose 5 herë më shumë; nga 21,1 lekë që është kërkuar në periudhën 2002-2011.

5. KLSH-ja i ka kushtuar një vëmendje të posaçme rritjes së forcës rekomanduese të institucionit për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara. Për gjetjet nga auditimi KLSH-ja ka dhënë rekomandimet përkatëse në format: shpërblim të dëmit shkaktuar buxhetit; masave me karakter organizativ, administrativ dhe disiplinor; propozime për ndryshim aktesh ligjore e nënligjore dhe kallëzimeve penale.

KLSH-ja u ka rekomanduar subjekteve të audituara 3521 masa me karakter organizativ, administrativ dhe disiplinor, nga të cilat janë pranuar 1937 masa ose 55% e masave të rekomanduara. Në proces shqyrtimi nga subjektet janë 1584 masa.

KLSH-ja ka paraqitur pranë organit të prokurorisë 47 kallëzime dhe indicie penale dhe 4 dosje auditimi. Pjesa më e madhe e kallëzimeve penale konstatohet në auditimin e njësive të qeverisjes vendore (25 kallëzime), e ndjekur nga auditimi i aseteve dhe mjedisit (12). Në këto kallëzime penale janë ngarkuar me përgjegjësi penale 129 persona, të cilët janë titullarë institucionesh, nëpunës të nivelit drejtues e të tjerë.

Në raport nuk ka informacion lidhur me masat e rekomanduara për shpërblim dëmi shkaktuar buxhetit, ndaj ky informacion duhet të plotësohet nga institucioni. Gjithashtu, me rëndësi është të plotësohet informacioni për shkallën e arkëtimit në buxhet të masave për shpërblim dëmi.

VI. Drejtimet kryesore të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2018.

Disa nga drejtimet kryesore, në të cilat duhet të fokusohet puna e KLSH-së për vitin 2018 janë:

1. Forcimi i pavarësisë së institucionit, për të siguruar auditime të paanshme dhe objektive.
2. Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.
3. Auditim me bazë risku, për të siguruar rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike.
4. Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës, i cili ka një rol të rëndësishëm në përdorimin me ekonomi, si dhe në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike.
5. Thellimi i auditimit të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet konsolidimit dhe përdorimit të elementeve të tij në auditimet e përputhshmërisë financiare dhe të performancës.
6. Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.
7. Përmirësimi i cilësisë së auditimit për të rritur dobinë e tij, KLSH-ja duhet të adoptojë sistemin e menaxhimit të cilësisë, i cili përfshin kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e saj. Kontrolli i cilësisë duhet të konsolidohet nëpërmjet zbatimit me korrektësi të kuadrit ligjor e rregullator. Ky kontroll duhet të mbështetet nga sigurimi i cilësisë i cili kryhet nga persona që nuk kanë marrë pjesë në procesin e auditimit.
8. Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nëpërmjet përmirësimit të procedurave brenda institucionit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional. Rol të

rëndësishëm ka këtu bashkëpunimin me Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe ngritja e nënkomisionit parlamentar me fokus KLSH-në.

9. Rritja e impaktit të raportimeve të KLSH-së, duke zgjeruar bazën e përdoruesve të tyre.

10. Forcimi i luftës kundër korrupsionit. Rëndësi ka hartimi dhe miratimi nga Kuvendi i ligjit për përgjegjësinë materiale.

11. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe aftësive audituese.

12. Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar e rajonal e ndërkombëtar.

13. Me gjithë rritjen e konsiderueshme të transparencës në publikimin e rezultateve të auditimit, KLSH-ja duhet të fokusohet më shumë në drejtim të përcjelljes profesionale dhe të kuptueshme të mesazhit të auditimit të palët e interesuara dhe të qytetarëve.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Kush ka pyetje për raportimin e kryetarit të KLSH-së?

Po, urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj kryetarin e KLSH-së dhe stafin për punën dhe angazhimin e tyre në realizimin e misionit në zbatim të ligjit “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në fakt, në fjalën tuaj thatë se ditën e hënë keni zhvilluar një konferencë në bashkëpunim me SIGMA-n, pyetja ime: si e shikoni në terma konkretë këtë bashkëpunim, e shikoni thjesht si një rritje të numrit të raportimeve të auditit, apo edhe të aktiviteteve të tjera të përbashkëta që ju zhvillonin me parlamentin?

E dyta, prej disa vitesh ju raportoni dhe keni një numër të lartë trajnimesh për audituesit e KLSH-së, gjithashtu, edhe në fjalën tuaj thatë se gjatë vitit 2017 janë realizuar 4317 ditë trajnime, duke mundur një numër mesatar prej 28,5 ditë trajnimesh për çdo auditues. A është menduar nga ana juaj për t’i certifikuar këta auditues?

E treta, sigurimi i cilësisë është një proces i rëndësishëm i punës së institucionit tuaj. Në fjalën tuaj dhe në raportin që ju na keni paraqitur theksohet se KLSH-ja duhet ta përmirësojë cilësinë audituese në drejtim të mbledhjes dhe analizimit të informacionit për subjektet që auditohen, dokumentimit të plotë e të vazhdueshëm të deklaratës kundër konfliktit të interesit, zhvillimit dhe dokumentimit të detajuar të takimit përmbyllës me

subjektin e audituar dhe plotësimit tërësor të evidencave, të rezultatit të auditimit sipas formës, përmbajtjes dhe afateve përkatëse. Pyetja ime: a keni ju një program të qartë pune, ose një plan masash për përmirësimin e procesit të sigurimit të cilësisë?

E fundit, a keni ju si institucion, si KLSH, një bashkëpunim me auditimin e brendshëm për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet?

Faleminderit, zoti kryetar!

Erion Braçe – Zoti Leskaj, keni fjalën.

Do t'ju lutem që përgjigjet të jenë të shkurtra dhe konkrete.

Bujar Leskaj – Së pari, zoti kryetar, do të më lejoni të shpreh falënderimet e mia për draftrezolutën, për hartuesin e saj dhe për zonjën Gjylameti, si referuese e draftrezolutës, për të cilën shpresoj dhe uroj të kalojë e të votohet në Kuvendin e Shqipërisë. Këto falënderime i shpreh me seriozitetin maksimal dhe me respektin për të gjithë komisionin.

Ne pa dyshime, siç kemi bërë edhe me rezolutat e tjera, pasi të kalojë nga Kuvendi, do të hartojmë planin e punës për plotësimin e saj. Në rast se do të keni mundësi ta evidentoni aty, se ne punojmë edhe në kushtet e burimeve njerëzore të kufizuara (nuk i heq asnjë presje kësaj rezolute, se ajo është e drejta juaj), duke ju falënderuar për vlerësimin që i bëtë KLSH-së, kërkoj të vlerësoni punën tonë, të Departamentit të Auditimit të Performancës, veçanërisht të drejtorit të tij, dr. Rinald Muça.

Rezolutat mbeten në memorie të Kuvendit, në memorien historike. Drejtori dhe departamenti kanë bërë një punë voluminoze këto vite dhe, në kushtet e burimeve të kufizuara, kjo punë merr vlera edhe më të mëdha.

Erion Braçe – Dakord.

Bujar Leskaj – E theksoj këtë gjë, pasi gjatë punës sime në këto vite, ndoshta edhe stafin e kam rënduar shumë, sepse ne kemi mbetur pak në dogmatizëm për numrin e auditimeve, pra duke pasur si qëllim të mos e ulim numrin e auditimeve, jemi sforcuar jashtë masë. Auditimi i performancës, për të cilin jam krenar që është ideja ime, të cilën e kam deklaruar në muajin nëntor të vitit 2011 në Komisionin e Ekonomisë, pastaj e zgjerova dhe e implementova me drejtorin, me Rinaldin, do të jetë shtylla e ardhshme e KLSH-së. Jam dakord me vërejtjen e zonjës Gjylameti, pra ne vërtet jemi 10%, por këto janë resurset tona. Për shembull, për sivjet kemi objektivin të realizojmë 20% auditime për performancën. Megjithatë, shpreh falënderim për draftrezolutën dhe hartuesin e saj.

Po kaloj te pyetjet e koleges Dhima. Natyrisht, për sa i përket aktivitetit që ne zhvilluam me SIGMA-n dhe se si e shikojmë bashkëpunimin me parlamentin, unë e kam

deklaruar edhe gjatë punës sime se viza të bardha kam vetëm Kushtetutën, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Të paktën në çdo deklaram që kam bërë në publik dhe në Komisionin e Ekonomisë në masën mbi 90% janë deklarime institucionale, nuk janë deklarime personale, duke përjashtuar ndonjë batutë të momentit. Kur ne vendosim aty që mbështetemi në rezolutat e Kuvendit, në mbështetemi në punën e Kuvendit. Ajo është pjesë e filozofisë së punë sonë dhe unë jam shumë i kënaqur që nga viti në vit e kemi rritur këtë bashkëpunim. Një nga drejtuesit e lartë të SIGMA-së bëri një konstatim për ne. Duke vlerësuar punën e KLSH-së, tha se KLSH-ja ka kaluar nga një institucion që zhvillohej brenda vetes dhe kërkonte brenda vetes, në një institucion që kërkon partneritet, që është i hapur me të tjerët. Partneri im kryesor është Kuvendi i Shqipërisë. Ne e kemi përcjellë strategjinë 2018-2022, por edhe në atë të viteve 2013-2017 partner kryesor kemi pasur Kuvendin. Kemi vendosur qytetarët të parët, pastaj Kuvendin. Motoja jonë është: KLSH-ja shërbyes i qytetarit dhe “*watch dog*” i Kuvendit të Shqipërisë. Natyrisht, bashkëpunimin me Kuvendin e konceptoj si një bashkëpunim të vazhdueshëm, të mbështetur mbi parime dhe standarde. Për fatin tonë të mirë, si institucion suprem i auditimit, mbështetja nga Komisioni i Ekonomisë ka qenë permanent në vite. Për fatin tonë të mirë, por edhe timin, mbështetja e Kryetarit të mëparshëm të Kuvendit, por edhe Kryetarit aktual të Kuvendit është pozitive për institucionin dhe është një mbështetje e fortë për institucionin. Tek aktiviteti që zhvilluam, tema ishte e zgjedhur nga SIGMA, e cila ka 10 vjet që punon për këtë qëllim. Dokumenti i parë, memorandum i Stambollit, është i vitit 2011 midis SAI-ve të vendeve anëtare dhe parlamenteve të vendeve anëtare, që organizohen nën ombrellën e Digibudget, SIGMA-s dhe Gjykatës Europiane. Dokumenti i dytë është i Budvës i vitit 2013; një dokument tjetër është i vitit 2015, ku ne kemi marrë pjesë në Stamboll së bashku me një përfaqësues të Komisionit të Ekonomisë, deputetin Ervin Koçi, dhe jemi tek ato SAI-e, sa arritëm që këtë aktivitet ta zhvillonim vetë ne si KLSH, me SIGMA-n dhe Kuvendin e Shqipërisë. Mesazhet e Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, mesazhet e kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe sekretarit të Komisionit të Ekonomisë, përcjellë nëpërmjet akademik Anastas Angjeli, janë mesazhe që tregojnë se bashkëpunimi ynë do të vazhdojë. Siç ia kërkoja zyrtarisht edhe zotit Ruçi, ka ardhur koha që Kuvendi i Shqipërisë dhe KLSH-ja, në kuadër të politikave që Kuvendi ka ndërmarrë për rritjen e mekanizmave të bashkëveprimit me institucioneve kushtetuese, të nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi, bashkëpunimi, në të cilin do të parashikohet edhe ngritja e nënkomisionit, për të cilin kryetari ka dhënë mbështetjen e plotë, pra një nënkomision brenda Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, ose edhe një komision i

pavarur, por këtë e gjykon Kuvendit. Por marrëveshja me Kuvendin e Shqipërisë e fuqizon dukshëm edhe potencialin e rekomandimeve tona. Nga ana tjetër, mendoj se kjo marrëveshje, por mbetet ta vendosë Kryetari, kryesia e Kuvendit, kryetarët e Komisioneve, deputetët, i shërben ndjeshëm Kuvendit për arsye se, siç rekomandohet edhe në literaturë, deputetët këtë kontroll të menaxhimit të financave publike, të pasurisë publike e bëjnë nëpërmjet një agjenti të tyre, siç është KLSH-ja. Ne nuk kemi as ndonjë kompleks inferioriteti, as superioriteti, por në punën tonë e konsiderojmë veten shërbëtorë të qytetarë dhe agjentë të Kuvendit. Madje, edhe ai termi “*watch dog*” përdoret profesionalisht, qenë roje, gardian i financave publike.

E dyta, është një kënaqësi për mua personalisht që në këto vite krijuam një traditë të mësuarit të vazhdueshëm dhe arritën 28 ditë trajnime në vit. Praktikisht, audituesit tanë zhvillojnë trajnime 1 muaj në vit. Ky është tregues që institucionet ndërkombëtare e kanë kërkuar me vite këtë dhe është një tregues profesional. Natyrisht, këto janë profesione për të cilat ke nevojë të përditësohesh dhe të përmirësohesh. Dija nuk ka fund kudo, por veçanërisht në auditim. Ne kur miratuam ligjin në vitin 2014, dhe unë i kam mirëkuptuar edhe pozicionet tuaja të brendshme dhe të kryetarit të Komisionit, pjesën e certifikimit e lamë të hapur. Për të qenë të sinqertë, ligji ka nevojë për një përmirësim që të certifikojmë edhe audituesin e jashtëm publik, nën përvojën e kolegëve tanë kroatë apo polakë. Ne do t’i sjellim propozimet për ndryshime ligjore si KLSH dhe besoj se do të gjejmë mirëkuptimin tuaj ta plotësojmë edhe këtë punë. Nga ana tjetër, ne do të japim certifikime të rangut që dëshmojnë kualifikimin e audituesve të KLSH-së.

Përpara disa muajve, besoj se ju jeni ne dijeni, Kryeministri, Këshilli i Ministrave, nëpërmjet një VKM-je ka nxjerrë një urdhër për testimin e administratës. Është një VKM, në frymën e së cilës, kuptohet ne jemi institucion i pavarur, unë si kryetar i KLSH-së e implementova për KLSH-në. Tashmë urdhri i kryetarit të KLSH-së është botuar në Fletoren Zyrtare për trajnimin dhe testimin e të gjithë audituesve të KLSH-së në muajin qershor. Kuptohet që ata auditues, të cilët nuk do ta kalojnë testimin, nuk do të qëndrojnë në KLSH. Përfitoj nga rasti që t’ju ftoj ju, si Komision i Ekonomisë, të caktoni një ose dy deputetë për të ndjekur këtë procedurë. Vendimi im ishte tërësisht në frymën e vendimit të Kryeministrit. Aty është parashikuar edhe një përfaqësues i ASPA-s, por ka edhe ekspertë të pavarur. Ky është një testim, por në thelb nuk do ta konsiderojmë, në kuptimin ngushtë, si një testim apo provim për largim. Në fakt, do të jetë një testim për certifikim. Ky proces do të zhvillohet një herë në 4 vjet, në bazë të vendimit të kryetarit në KLSH dhe do të pajiset me këto certifikata.

Pyetja e tretë ishte: a keni ju një program pune për përmirësimin e cilësisë?

Pa dyshim që kemi, por përmirësimi i cilësisë në raportet e auditimit nuk merr fund asnjëherë jo vetëm te ne, por edhe në botë. Me të drejtë neve na tërhiqet vëmendja se raportet tona janë të gjata, por vendimin e kryetarit në thelb ne e konceptojmë edhe si raport ekzekutiv.

Në kuadër të transparencës, unë e harrova ta them gjatë fjalës sime, ne kemi vendosur në web 98% të vendimeve të kryetarit për vitin 2017. Ky është një tregues relativisht i lartë dhe ato vendime janë si raporte ekzekutive, sepse përshkruajnë gjetjet e konstatuara dhe japin rekomandimet përkatëse.

Ne ende i kemi të gjata raportet, por ecim me shprehjen: “Shkruaj gjatë, sepse nuk kam kohë të shkruaj shkurt”. Kjo për arsyen se është shumë e vështirë të reduktosh materialet tona dhe ndonjëherë mua më është sugjeruar në medie të bëjë piramidën e përmbysur që të japë mesazhin kryesor. Ne përpiqemi dhe e bëjmë edhe te njoftimet tona këtë gjë. Në këtë kuadër, ne vazhdojmë të përmirësojmë cilësinë.

Unë po ju jap një fakt: para disa vjetësh ky proces në KLSH është kryer në mënyrë formale dhe kalonim 20% të dosjeve të auditimit, kurse tani ne kemi arritur në shifrën 30%. Në këtë proces ne kemi ngritur një komision *ad hoc*, i cili për 3 muaj e realizon dhe shqyrton procesin e sigurimit të cilësisë. Për këtë proces ne i përcjellim një raport të hollësishëm Kuvendit. Besoj se edhe ju tek ky raport u bazuat kur më bëtë pyetjen tuaj.

Ne jemi të bindur që do të vazhdojmë ta përmirësojmë këtë proces. Me mbylljen e projektit IPA, në korrik të vitit 2017, ne do të finalizojmë edhe një dokument bazë për përmirësimin e kontrollit të cilësisë në KLSH. Si tregues institucioni ynë është mbi nivelin mesatar dhe përpjekjet tona do të vazhdojnë edhe më tej. Ne kemi rreth një vit që përpiqemi për rregullime, në kuadër të kontrollit të cilësisë së procedurave të auditimit.

Pyetja juaj e katërt kishte të bënte me bashkëpunimin tonë me auditin e brendshëm.

Në vitin 2012, së bashku me ministrin e Financave të kohës, zotin Bode, kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për bashkëpunimin ndërmjet audituesit të jashtëm publik dhe audituesit të brendshëm publik. Për këtë marrëveshje, për hir të së vërtetës, kam gjetur mirëkuptim edhe te ministrat pasardhës të Financave. Më 12 prill të vitit 2017, kryetari i KLSH-së dhe ministri i Financave, zoti Arben Ahmetaj, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me synim: rritjen e performancës së auditimit të jashtëm, auditimit të brendshëm, si dhe veprimtarisë së inspektimit financiar publik. Me ministrin aktual të Financave ne u përpoqëm që ta kalonim në një shkallë më të lartë këtë marrëveshje. Për të

qenë i sinqertë me ju, kemi ende shumë për të bërë si ne, ashtu edhe audituesit e brendshëm, pra Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Unë mendoj se nuk mungon vullneti dhe as dëshira, nuk mungojnë as parimet dhe standardet, madje ne kemi një standard auditimi, të cilin e gjeta kur nënshkrova marrëveshjen me ministrin e Financave në vitin 2012, sepse ishte një ambient refraktar edhe në KLSH, por edhe në Ministrinë e Financave, që ne në shumë raste i njohim dhe i pranojmë rezultatet e auditit të brendshëm. Nga ana tjetër, audit i brendshëm e ka për detyrë dhe duhet t'i zbatojë gjetjet e auditimit të jashtëm. Madje mund t'ju them se dy nga kallëzimet kryesore të ministrit Gjyknuri janë mbështetur në punën e audituesit të jashtëm publik. Pra, ka qenë një kallëzim i bërë nga ne, që ministria e thelloi me strukturat e saj të brendshme, por kuptohet ne kemi mendimin tonë lidhur me auditimin e brendshëm dhe ata kanë shumë më tepër se ne për të bërë. Ende audituesit e brendshëm nuk funksionojnë normalisht, por vetëm në periudha kur ndërrohen pushtetet apo kur ngrihen koalicione të reja, pra nuk ka një vijimësi. Në rast se audituesi i jashtëm tashmë i është bindur opinionit se ka një vijueshmëri, do të ketë edhe më shumë profesionalizëm dhe totalisht depolitizim.

Faleminderit për pyetjet!

Erion Brace – Faleminderit, juve!

Po zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Përshëndetje të gjithëve!

Unë kam një koment, një sqarim dhe një pyetje.

Komenti im ka të bëjë me vlerësimin për punën 1-vjeçare të institucionit të KLSH-së në zbatim të Kushtetutës, ligjit, programit të punës që ka pasur, reflektimit dhe plotësimit të disa nga sugjerimeve, që rezoluta e vitit të kaluar ka bërë në funksion të mbështetjes së mirëqeverisjes dhe përdorimit të fondeve publike në vendin tonë.

Unë dua të sqaroj diçka lidhur me atë që ne po diskutojmë sot. Rezoluta do të jetë një tjetër, sepse kjo që na keni paraqitur sot është opinion i oponencës, që caktohet gjithnjë në një diskutim.

Pyetja është: përveç asaj që ju e theksuat, të cilën e kemi theksuar edhe ne, që do të kërkon një memorandum mirëkuptimi, duke i trajtuar të dyja palët, ne dhe ju, si partnerë, pavarësisht se ju jeni modest dhe thoni “agjenci”, çfarë kërkon ju, nga pikëpamja ligjore dhe institucionale, nga Kuvendi dhe komisioni për të rritur më tej punën tuaj në qëllim të funksionit tuaj? Çfarë kërkesash keni? Çfarë doni ju, qoftë ligjërish, qoftë institucionalisht, që ne t'ju mbështesim edhe më shumë?

Faleminderit!

Erion Braçe – Nuk besoj t'ju ketë gjetur pa përgatitur, zoti Leskaj? Kjo është hera e parë në 7 vjet, që një deputet ju thotë se çfarë doni.

Bujar Leskaj – Zoti kryetar, ju keni dyshime se mund të më gjeni ndonjëherë të papërgatitur?!

Erion Braçe – Jo, aspak, por kur lista është e hapur, krijohet vështirësi.

Bujar Leskaj – Nuk të kuptova.

Erion Braçe – Kur lista është e hapur, siç bëri zoti Angjeli, krijohet edhe vështirësi.

Bujar Leskaj – Në fakt, mos ma merrni për komplement, por profesor atë që ju thatë në fillim nuk e kuptova që ky nuk është një draftrezolutë. Ju u bëtë xheloz, meqenëse unë e vlerësova dhe e nderova relatoren?

(Diskutime pa mikrofon.)

Së pari, unë e falënderova me seriozitetin dhe zyrtarizimin më të lartë.

Së dyti, kam vetëm një sugjerim, që mund ta diskutojmë edhe më vonë: jam shumë dakord me të gjitha ato që ju thatë dhe nuk vë në dyshim asnjë presje dhe kërkova vetëm një vlerësim pozitiv për drejtorin e departamentit të performancës, zotin Muça.

Erion Braçe – Zoti Leskaj, mos krijoni përçarje.

Bujar Leskaj – Unë nuk po kërkoj për vete, sepse mua mund të më cenoni në karrierën time të ardhshme.

Anastas Angjeli – Zoti Bujar, ne bëjmë vlerësim për institucionin, kurse për punonjësit bëjeni ju. Po të doni mund t'u bëni edhe bust atje, sepse ne e kemi vetëm për institucionin dhe nuk merremi me individët. Pra, me individët merruni ju, jepuni dekorata, jepuni fletë nderi dhe çfarë të doni.

Bujar Leskaj – Profesor, ju jeni akademik dhe e dini shumë mirë që bustet bëhen pas vdekjes.

Ju lutem, pyetja juaj ishte sintetike dhe kërkon një përgjigje. Në radhë të parë, theksoj se ai është një postulat dhe e kam thënë që në fillim: KLSH-ja si një institucion suprem auditimi nuk bën politikë, por auditon zbatimin e politikave.

Unë jam i bindur se të gjithë qytetarët e Shqipërisë janë njerëz të mençur dhe e kuptojnë shumë mirë, por është edhe një pjesë që nuk duan ta kuptojnë, atëherë le të mos e kuptojnë, nuk shqetësohem fare. Këtë parim e kam pasur që ditën kur u nominova si kandidat dhe e përgatita atë platformë me mundim dhe deri sot. Ne, jo më kot në strategjinë tonë, edhe kjo kërkesë ishte imja, kemi modul një postulat të KLSH-së: “Shërbëstari i

qytetarit dhe *watchdog-u* i Kuvendit”. Fjalën “shërbestar “ e kam vendosur në respekt të mendimit filozofik të Mithat Frashërit, apostulli i nacionalizimit shqiptar.

Çfarë kërkojmë ne nga Kuvendi? Në vijim të frymës së bashkëpunimit dhe partneritetit që kemi krijuar me Komisionin e Ekonomisë, ne kërkojmë nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit për një periudhë 6-mujore.

Unë nuk do të resht së përsërituri se në gjithë këta vjet ne kemi pasur një bashkëpunim pa kushte dhe një bashkëpunim vërtet profesional, sepse aty ku ju e keni parë të arsyeshme për të na kërkuar llogari, na keni kërkuar dhe ne ju kemi dhënë përgjigjet tona, gjithashtu asnjëra palë nuk i ka shkelur parimet e veta, as ju dhe as ne.

Ne e kërkojmë nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje për një fakt të vetëm : në këta 6 muaj kryetari aktual i KLSH-së është jashtë çdo konflikti interesi. Unë nuk doja ta theksoja gjatë fjalës sime, sepse nuk është ndonjë interes i madh për t’u ripërsëritur kjo gjë për arsye se ne e kemi pasqyruar vendimin në *web*.

Në vendimin nr. 27, datë 20.04.2018 “Për kodin etik të kryetarit dhe të drejtuesve të KLSH-së”, në nenin 1 kam theksuar: “Kodi etik i kryetarit mbështetet në kodin e etikës së KLSH-së, në Kodin e Sjelljes së Deputetëve dhe në standardet kombëtare të auditimit publik”, pasi njoh edhe kushtet e kodit tuaj të etikës.

Nenin 2 ne e zbatojmë me respekt, pa asnjë kusht, me rigorozitet dhe përpikëri Kodin e Sjelljes së Deputetëve, të miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 61 datë 05.04.2018, punuar me ekspertë të OSBE-së dhe vende të tjera.

Gjithashtu, zoti Angjeli, më lejoni të citoj nenin 4, duke të treguar idenë time se çfarë kërkojmë ne nga Kuvendi dhe pse kemi mundësi që t’i bëjmë në 6 muajt në vijim.

Neni 4: “Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur, që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të cenojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaron publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mosrikandidim për t’u rizgjedhur kryetar i Konterollit të Lartë të Shtetit, duke ua bërë me dije edhe Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.”

Neni 5: “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Kodi i etikës së kryetarit dhe i drejtuesve të lartë të KLSH-së lexohet dhe zbatohet integralisht në tri dokumentet e cituara në nenin 1 dhe në këtë vendim.”

Pra, fakti që unë jam tërësisht jashtë çdo konflikti interesi na bën neve që marrëveshjen me Kuvendin dhe me kryetarin e Kuvendit ta kërkojmë për këto gjëra.

Së pari, për përmirësimin e ligjit tonë organik. Pra, ne e miratuam ligjin në vitin 2014 në një klimë të tensionuar ku unë, personalisht, kisha kundër gjysmën e maxhorancës, por, për fat, gjysmën tjetër e kisha pro. Gjithashtu, patëm edhe mbështetjen e DG Budget, SIGMA-s dhe gjithë të tjerëve, të cilët e vlerësuan punën tonë. Tani ne duhet të plotësojmë ligjin tonë për sa i përket problemit të certifikimit, që edhe deputetja e nderuar me të drejtë e ngriti.

Së dyti, KLSH-ja, e theksoj me përgjegjshmëri, ka nevojë për më shumë autonomi financiare. Me ligjin që ju miratuat KLSH-në e keni bërë një institucion model për sa i përket pavarësisë. Madje janë tri forume të larta të INTOSAI-t në të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe kryetari i tij ka qenë referues. Ka qenë 40-vjetori i deklaratës së Limës, në të cilën referoi drejtori i Departamentit të Performancës, takimi i kryetarëve të vendeve të BE-së dhe i vendeve kandidate, i cili u realizua një ditë para samitit të kryetarëve të shteteve në Sofje, ku mori pjesë edhe Kryeministri, në të njëjtën sallë, me të njëjtën pompozitet dhe zyrtarizëm e realizuam, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit pati një nga diskutimet kryesore, e cila u vlerësua nga Gjykata e Audituesve Europianë.

Kumtesa që unë mbajta, atje kam folur për rreth 30 minuta, për pavarësinë e institucionit dhe ndihma që ju na keni dhënë, e cila është e vendosur në ueb, u vlerësua së tepërmi. Pra, ka ardhur koha, nisur edhe nga fakti që unë si person nuk kam probleme me njeri dhe nuk jam në konflikt interesi, ne me guxim dhe ju me guxim të na jepni edhe autonominë financiare, e cila do të konfirmojë një nga parimet e ISSAI 10, që është deklarata e Meksikos, pas kësaj është deklarata e Limës e vitit 1977, por deklarata e Meksikos e vitit 2007 është dokumenti më i rëndësishëm. Në rast se ju si Kuvend i jepni Kontrollit të Lartë të Shtetit edhe autonominë financiare, autonomi e cila do të implementohet në vitin 2018, vit në të cilin nuk do të jetë më Bujar Leskaj, ai do të jetë në punë të tij, por një kryetar tjetër legjitim, i zgjedhur nga Presidenti dhe Kuvendi i Shqipërisë, kushdo qoftë ai i uroj suksese nga më të mirat, Kuvendi i Shqipërisë është një institucion model, duke e konfirmuar ne me marrëdhënien e bashkëpunimit, ju do ta orientoni KLSH-në, mendimi im, Kuvendi është

superior, sepse jeni të zgjedhur nga populli, të zbatojë më mirë të gjitha parimet e integritetit dhe të profesionalizmit.

Marrëveshja që ne do të bëjmë do të realizojë edhe atë, prandaj jo më kot e përmenda dhe e vlerësova. Këtë e them me sinjeritetin më të madh, sepse mekanizmin që ju po ndërtoni si Kuvend e kam bërë edhe me ndërkombëtarët, kjo pa dyshim është meritë e zotit Ruçi, juaja, e opozitës dhe e pozitës, si dhe e drejtuesve të komisioneve. Pra, mekanizmi i ndjekjes së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nuk është për të rritur kredibilitetin e një personi të veçantë, sepse unë punën time e kam bërë dhe do ta bëj edhe për këta 6 muaj dhe për këtë më mjafton Kushtetuta dhe ligji, por këto janë parime që sigurojnë një vijimësi dhe forcojnë llogaridhënien dhe transparencën, çka është problem në Shqipëri.

Largimi i një zyrtari të lartë, për të cilin gjatë auditimit konstatohet shkelje, nuk është dëshirë personale imja, është parim për mirëmenaxhim dhe tregues i një qeverisje të mirë, për të mos përmendur parimet e OECD-së dhe të mirëqeverisjes. Më erdhi mirë që edhe relatorja Gjylameti e kishte vënë memorandumin e mirëkuptimit, por ne dhe ju duhet ta fusim në diskutim ligjin për përgjegjshmërinë materiale. Personalisht nuk kërkoj të penalizojë njeri me atë ligj, por kërkoj të rritet shkalla e përgjegjshmërisë, madje tek ai ligji do të jetë edhe përgjegjshmëria e drejtuesve të institucioneve të pavarura kushtetuese, prandaj të gjithë duhet ta forcojmë dhe ta ndiejmë që mbi ne nuk ka individë, sepse mbi ne është Kushtetuta dhe ligji dhe të gjithë do të japim llogari një ditë përpara ligjit.

Këto janë qëllimet që ne kërkojmë nga marrëveshja dhe kjo është ajo çka unë kërkoj nga Komisioni i Ekonomisë. Në këtë periudhë, për sa kohë ju do të vendosni që të ngrini nënkomision, personalisht këtë e kam theksuar me të gjithë partnerët, kam qenë i kënaqur në raportimin e llogarisë që kam bërë dhe në llogarinë që më është kërkuar, si dhe në informacionet dhe raportet që më ka kërkuar komisioni, veçanërisht kryetari i komisionit, edhe kur ka qenë deputet i opozitës dhe sot që është deputet i pozitës, si dhe në mbështetjen personale që më ka dhënë. Gjatë vitit 2017, kemi pasur dy raste provokimi nga individë dhe forume, por kjo nuk ka rëndësi, i jam drejtuar kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Kryetarit të Kuvendit, duke dhënë të gjitha sqarimet për punën tonë, duke qenë i hapur dhe duke kërkuar që ju si Komision i Ekonomisë të ngarkoni ekspertë për të verifikuar punën tonë, çka nuk është në një linjë me standardet, pasi pavarësia e institucioneve nëpërmjet auditimit është e shenjtë dhe ruhet me fanatizëm kudo në botë. Nuk e di, por besoj se i përmbledha të gjitha, zoti Angjeli...

Erion Braçe – Zoti Angjeli ka një koment...

Bujar Leskaj – Dua t’ju them diçka, këto gjëra i kërkojmë për t’i shërbyer qeverisjes. Motoja e kongresit të parafundit, e kongresit të XXI të INTOSAI-t ishte Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare. Po ju rikujtoj se në vitin 2015 kemi organizuar edhe një konferencë me këtë moto, kjo ka qenë filozofia ku kemi konceptuar punën tonë në shërbim të qeverisjes kombëtare, të komisionit, të Kuvendit dhe më gjerë.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Ne kuptuam këto pesë gjëra:

E para, kemi një marrëveshje, por duhet ta ngremë në nivel memorandumit të ri...

Bujar Leskaj – Ne kemi marrëveshje xhentëlmenësh, nuk e kemi *de jure*...

Anastas Angjeli – Së dyti, është diskutuar disa herë pasja e një nënkomisioni për zbatimin e buxhetit, të auditit e të tjera.

Së treti, kërkon dy përmirësime në ligj, të cilat nuk u bënë gjatë vitit 2014, kur është diskutuar për muaj të tërë.

Së katërti, kërkon pasjen e një ligji për përgjegjësinë materiale, këtë e kërkojmë edhe ne, por ligjin nuk e bëjmë ne, e bëni ju dhe qeveria...

(Diskutime pa mikrofon)

Jeni ende të gjithë me ligjin e vitit ’84 të Mehmet Shehut për çështjen e përgjegjësisë materiale.

Së pesti, kërkon më tepër angazhim nga Drejtoria e Mbikëqyrjes për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe të sugjerime tuaja.

Bujar Leskaj – Faleminderit, profesor, por jo nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, ne e kërkojmë nga Kuvendi...

Anastas Angjeli - Kuvendi është godina, brenda ka drejtori dhe institucione, të cilat merren konkretisht me ndjekjen e institucioneve të pavarura dhe në Kuvend është një institucion funksional që merr porosi dhe ka një rregullore sesi vepron. Pra, këto të pesta ishin çështjet që ju kërkuat.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Gjylameti, fjala për ju.

Blerina Gjylameti – Së pari, kryetar, gjatë fjalës suaj dëgjova disa herë kërkesa për shtim buxheti. Në dijeni time, këtë e them me përgjegjësi të plotë, ju nuk keni dorëzuar asnjë kërkesë për shtim buxheti pranë komisionit tonë...

Erion Braçe – Kërkesa ka ardhur dhe ua kam dhënë specialistëve të komisionit dhe ajo sa më parë do t’i paraqitet Byrosë së Kuvendit.

Blerina Gjylameti – Ka ardhur tani, por, kur është shqyrtuar projektbuxheti, nuk na ka ardhur një kërkesë e tillë.

Për sa i përket çështjes tjetër, marrëdhënia midis Kuvendit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit është një marrëdhënie partneriteti dhe nuk ka nevojë për një marrëveshje në momentet kur ka një marrëdhënie të tillë. Unë nuk besoj se do të ndryshojë gjë, pasi sot që jemi duke folur, marrëdhënia ndërmjet parlamentit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit është një marrëdhënie, e cila funksionon dhe ka nevojë për përmirësime.

Për sa i përket pjesës tjetër, për faktin që më sugjeruat të vlerësoja më mirë drejtorin e Drejtorisë së Performancës, doja t’ju thosha, zoti kryetar, edhe pse keni vite që drejtoni Kontrollin e Lartë të Shtetit, ende sot nuk i ndaheni detyrës suaj të parë, të deputetit, prandaj vazhdoni ende të bëni sugjerime dhe jo kërkesa.

Unë e ndoqa me shumë vëmendje fjalën tuaj, te rezoluta me sa duket do të keni pasur shkëputje vëmendjeje te pjesa e vlerësimit, sepse në pikën 3 të raportit, jo të rezolutës, ka pikërisht një vlerësim për çështjen e auditimit të performancës, e cila ka realizuar objektivat e parashikuara dhe në rritje të numrit të auditimeve e me radhë. Ky me sa duket do të ketë qenë një moment shkëputjeje.

Sugjerimet dhe më pas fokusi dhe detyrat e lëna për vitin 2018 të shërbejnë për t’u përmirësuar më shumë dhe për t’u fokusuar në atë që ju herë pas here e përsëritët gjatë fjalës suaj, ku flisni pikërisht për një menaxhim më të mirë, me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike. Pra, nëse flasim për çështjen e performancës, pikërisht ne fokusin e kemi te rritja e eficiencës, rritja e efektivitetit dhe ekonomisë, përdorimit të parasë publike.

Ndërkohë, unë kam një pyetje, kjo në bazë të raportit që lexova, e kam fjalën për Bankën e Shqipërisë, për çështjen e shpenzimeve kapitale të Bankës së Shqipërisë për vitet 2010-2014, kryesisht për blerjen e ish-hotel Dajtit dhe rikonstruksionin e godinës qendrore. Në raportin tuaj bëhet me dije që janë financuar me emetim apo rritje të ofertës monetare, pavarësisht faktit se të ardhurat mund të ishin të mjaftueshme për të bërë një blerje të tillë. Përsëri në raportin tuaj keni theksuar faktin që nuk ka rritje të rezervës për shpenzimet kapitale të kryera apo të parashikuara ndër vite, pra nga viti 2007 e në vazhdimësi dhe ajo që keni theksuar është fakti që nuk ju është vënë në dispozicion asnjë informacion për vitin 2015-2016 në lidhje me: vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e rezervave në mbështetje të shpenzimeve kapitale, në transferimin e fitimit dhe vazhdoni me një sërë vendimesh të tjera. Ju këtu keni theksuar vetëm periudhën 2015-2016. Për t’ju dhënë mundësi të shpreheni për përputhshmërinë e administrimit të rezervave

të financimit, të shpenzimeve kapitale, edhe pse këto ju kanë munguar për vitin 2015-2016, pyetja që unë kam është: 4 vjetët e tjera nuk ju kanë mjaftuar të shpreheni për këtë çështje?

Atëherë, ju këtu shpreheni se ju mungon ose ju është refuzuar informacioni nga Banka e Shqipërisë për vitin 2015-2016, për sa u përket vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, në lidhje me përshtatshmërinë e rezervave në mbështetje të shpenzimeve kapitale. Ndërkohë, ju përmendni vendimet për transferimin e fitimit dhe vini në dukje faktin që, pavarësisht se për vitet 2010-2014 të ardhurat kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet kapitale, kemi një emetim të monedhës, ndërkohë blerja e hotelit...

Erion Braçe – Cila është pyetja?

Blerina Gjylameti – Pyetja ime është: a kishit mundësi që nëpërmjet informacioneve që keni marrë deri në vitin 2014 të vlerësonit se çfarë është bërë për këtë rast? A mund ta adresoni? A keni shkelje? A keni keqpërdorim apo duhej të kishit edhe periudhën 2015-2016? Cili është qëndrimi juaj për këtë çështje në tërësi?

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Leskaj!

Bujar Leskaj – Së pari, kërkesat e Kontrollit të Lartë të Shtetit për mbështetje dhe suport financiar kanë qenë në vijimësi dhe janë adresuar edhe në Ministrinë e Financave, në momente të caktuara edhe te kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe te Kryetari i Kuvendit, por kuptohet që në respekt të raporteve të partneritetit që ne kemi me qeverinë, me Ministrinë e Financave asnjëherë nuk i kemi bërë këto kërkesa publike apo të luanim rolin e qaramanit. Kërkesat tona, po jua citoj disa prej tyre, janë përcjellë në Ministrinë e Financave dhe në Komisionin e Ekonomisë, për fond shtesë në buxhetin e vitit 2018, për zërin “paga”, si dhe janë përcjellë: programi buxhetor afatmesëm 2018-2020, nr. 51, datë 28.04...

Blerina Gjylameti – Zoti Leskaj, fjalën e kisha për projektbuxhetin, kjo ka ardhur më pas dhe jo në fillim...

Erion Braçe – Zonja Gjylameti, kanë ardhur të gjitha propozimet.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, edhe më parë.

Bujar Leskaj - Faza e dytë, datë 04.09.2017, përgatitja e projektbuxhetit 2018, nr. 1030, datë 06.10.2017. Kërkesë për buxhetin e KLSH-së në vitin 2018, datë 31.10.2017 dhe kërkesa për rishikim buxheti për buxhetin e KLSH-së, nr. 314/7, datë 18.05.2018.

Në vijimësi i jemi drejtuar ministrit dhe kryetarit dhe nuk kemi dashur të krijojmë një situatë, të dalë në media, që qeveria nuk mbështet KLSH-në, ajo e godet atë dhe nuk i krijon mundësitë financiare. Kemi kërkuar edhe për stafin tonë që 8 vetë, të cilët janë me

grada shkencore, të parashikohet një pagesë shtesë për vështirësi në punë dhe vjetërsi në profesion si në të gjithë administratën shqiptare. Kemi kërkuar fonde edhe për 10 ekspertë të jashtëm që kemi nevojë në vijimësi. Në gjithë këta vjet, puna që është bërë për sa i përket modernizimit, pa ekspertët e jashtëm, pa profesorët që kemi, nuk mund të realizohet.

Kemi besim që ajo çka nuk u arrit në buxhetin që u miratua në Kuvend në fund të vitit 2017, për vitin pasardhës, në rast se qeveria do të bëjë rishikimet, të cilat nuk janë praktikë që e mbulojmë ne si KLSH, dhe të shikojë patjetër problemin tonë, për arsye se jemi bllokuar tek ekspertët e jashtëm, madje tani nuk po rekrutojmë të gjithë numrin e personave, për arsye se nuk dalin fondet që kemi në dispozicion. Kjo nuk është shqetësuese aq sa për t'u theksuar dhe unë jam treguar i kujdesshëm.

Për sa i përket problemit të Bankës së Shqipërisë, ju cituat një raport konfidencial. Raportet që kryetari merr vendimin duke i konsideruar raporte konfidenciale, ato trajtohen si të tilla. Jam gati të jap përgjigje për të gjithë raportin dhe problematikën, por në një ambient konfidencial.

Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur prestigjioz financiar i rëndësisë së veçantë në vend. Kur ne të diskutojmë atë raport për viti 2017, siç ju me të drejtë e kërkuat, jemi gati të vijmë të japim sqarimet tona.

Në vijimësi, kemi ushtruar veprimtarinë tonë audituese në Bankën e Shqipërisë. Që prej vitit 2012, opinionin publik, por edhe ekspertët që ndjekin problemet e ekonomisë, edhe ju si deputetë, jeni në dijeni të punës sonë, punë e cila si të gjitha institucionet financiare në vend, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave apo edhe si KLSH-ja, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Banka e Shqipërisë ka nevojë për përmirësime ligjore dhe për më tepër transparencë, por kuptohet, mbi të gjitha prevalojnë ato standarde që zbatojnë edhe simotrat e saj në Europë.

Për sa i përket problemit që ne nuk kemi marrë informacionin e duhur për vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, kjo mungesë informacioni ndodh edhe në shtete të zhvilluara europiane dhe është një problem që e kanë bankat me institucionet e auditimit, problem që vazhdon në vijimësi, që ndoshta Kuvendi mund t'i japë drejtim kur ta gjykojë.

Të gjitha auditimet tona me Bankën e Shqipërisë kanë një linjë logjike dhe nga viti në vit ne përmirësojmë punën tonë. Për vitin që flasim, në ekipin e auditimit të Bankës së Shqipërisë kishim një drejtues, i cili ka certifikatën përkatëse. Puna e grupit të auditimit u ndoq drejtpërdrejt nga drejtoresha e Përgjithshme, ku u synua të arrihej maksimizimi i punës

së grupit. Mendoj se vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet tona i shërbejnë shëndoshjes së gjendjes së Bankës së Shqipërisë, e cila ka përgjegjës, drejtues, independentë tërësisht të vlerësuar nga ju, Guvernatorin e Shqipërisë dhe Këshillin Mbikëqyrës.

Erion Braçe - Po, zonja Gjylameti, urdhëroni!

Blerina Gjylameti – Zoti Leskaj, nuk e keni konsideruar të nevojshme t’i drejtoheni Kuvendit të Shqipërisë me një shkresë në momentin që jeni penguar për të ushtruar veprimtarinë tuaj audituese? Fakti që një institucion, i cili raporton në Komisionin e Ekonomisë në të njëjtën mënyrë siç raportoni ju pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, refuzon të japë informacionin e nevojshëm, nuk e keni konsideruar të nevojshme t’i drejtoheni komisionit ku raporton ky institucion që ju pengon në veprimtarinë tuaj audituese?

Bujar Leskaj – Për të qenë të sigurtë, ju lexuat raportin tonë, domethënë ne ju jemi drejtuar juve, Kryetarit të Kuvendit dhe Komisionit të Ekonomisë. Besoj se nuk e keni gjetur atë raport në mënyra informale. Ju po lexoni raportin që kemi përcjellë te Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, te zëvendëskryetari dhe kryetari i Komisionit të Ekonomisë. Tek ai raport shtrohen edhe problemet. Ne nuk mund të atakojmë një institucion si Banka e Shqipërisë në këto raste. Punën tonë e kemi kryer dhe do të vazhdojmë ta kryejmë.

Raportit tonë nuk i heqim asnjë presje dhe pikë. Vërtet ka pasur pengesa por problemet ndërmjet KLSH-së, Bankës së Shqipërisë dhe Guvernatorit nuk kanë qenë shqetësuese në atë nivel sa të shqetësohej Kuvendi i Shqipërisë dhe të bëheshin publike. Ky është një proces që vazhdon në vijimësi. Çdo vit ne kemi pasur probleme. Edhe me ndërkombëtarët deklaroj atë luftë 1-vjeçare që bëme për sa i përket aksesit në informim. Askesin në informim e kemi 100% falë Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit të Ekonomisë etj., por në fakt, gjatë punës ka edhe pengesa e mangësi dhe nuk mund të shqetësojmë gjithmonë Kuvendin.

Kemi konstatuar gjetje dhe kemi dhënë rekomandimet tona për Bankën e Shqipërisë, ia kemi përcjellë Guvernatorit dhe Këshillit Mbikëqyrës, të cilët janë institucionet përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e politikave monetare dhe menaxhimin e Bankës së Shqipërisë. Kuptohet që ne do të ruajmë edhe pavarësinë e tyre. Jam përpjekur dhe do të përpiqem që në punën e KLSH-së të mos kemi cenime të pavarësisë së institucioneve të tjera, në veçanti institucioneve kushtetuese dhe atyre më të rëndësishmeve, siç është Banka e Shqipërisë.

Erion Braçe - Faleminderit!

Zoti Leskaj, kam një pyetje për të cilën do të doja një përgjigje sa më të shkurtër dhe konkrete.

Në raport thoni që vlera e dëmit në të ardhura arrin në 92,7 miliardë lekë. Dua të di çfarë përfaqëson kjo vlerë dëmi, sepse është një shifër e jashtëzakonshme. Shifër kaq e madhe për një vit financiar, më duket anormale!

Bujar Leskaj – Zoti kryetar, raportin tonë të auditimit që ju dërgojmë, e shoqërojmë edhe me anekse. Në faqen 132, tabela 2, është evidenca e parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomikitetit, të cilat kanë sjellë efekt negativ financiar në të ardhurat dhe subjektet e buxhetit të shtetit.

Ju kërkuat informacion për të ardhurat. Këto janë të ardhura të munguara, se tabela e parë është e atyre që ne klasifikojmë dëm ekonomik, janë në këto institucione: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila ka një vlerë të konsiderueshme, 19 miliardë lekë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë diçka më pak, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, për sa i përket problematikës së gjobave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike...

Erion Braçe - Zoti Leskaj, jam i qartë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, 50,2 miliardë lekë.

Çfarë përfaqësojnë këto, sepse vetëm me dy zëra shifra shkon në 69 miliardë lekë? Mbetem i paqartë!

Bujar Leskaj – Nga auditimi i ligjshmërisë së bllokimit të veprimtarisë dhe sekuestrimit të pajisjeve të lojërave të fatit u konstatua se nga inspektorët e kontrollit të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit nuk janë vendosur gjoba për 4 mijë e 761 mjete të konfiskuara në vitin 2015 në shumën 26 miliardë e 583 milionë lekë dhe për 5 mijë e 581 mjete të konfiskuara në vitin 2016 në shumën 29,5 miliardë lekë. Në total për të dy vjetët, në 1940 subjekte të palicencuara në shumën 50,2 miliardë lekë.

KLSH-ja ka konstatuar se informaliteti në këtë sektor vazhdon të mbetet i lartë dhe në të ardhmen ka vendosur të kryejë një auditim performance ku do të vlerësohen efektet e masave të ndërmarra në vitet e fundit, përfshi këtu dhe rezultatet e aksionit final “Fundi i marrëzisë”. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për mangësitë dhe për suksesin e përkohshëm të këtij operacioni, i cili u trumbetua dhe u mirëprit nga opinioni.

Më lejoni, kryetar, meqenëse me të drejtë zonja Gjylameti bëri një vërejtje miqësore që mua më ka ngelur kostumi i deputeti, mua në fakt më ka mbetur kostumi i qytetarit vlonjat.

Mendoj se edhe Kuvendi para një viti ka bërë një gabim duke votuar shtyrjen e afatit të ligjit për lojërat e fatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, singërisht, nuk kishte asnjë nënkontekst, madje kam menduar si kryetar i KLSH-së t'ju drejtohem përsëri që të vendosni ato penaltete dhe kufizime që kanë qenë në variantin e parë të ligjit.

Erion Braçe - Ka pyetje të tjera?

Zoti Bushaj, ka një mbledhje tjetër në orën 12.00 në këtë sallë!

Xhevit Bushaj - Duke vlerësuar veprimtarinë e KLSH-së...

Erion Braçe - Bëj pyetjen, zoti Bushaj! Vlerësimet i mori të gjitha KLSH-ja.

Xhevit Bushaj – A është i mjaftueshëm personeli...

Erion Braçe - Zoti Bushaj, e ka thënë të paktën tri herë këtë gjë.

Xhevit Bushaj – Sa është realizuar programi për vitin 2017? Si ka qenë bashkëpunimi i institucionit tuaj...

Erion Braçe - Zotëri, zoti Leskaj i ka thënë deri tani të paktën tri herë këto gjëra! Për këto gjëra i morëm shpjegimet, madje kryetari kërkon shtesë edhe të buxhetit të burimeve njerëzore...

Xhevit Bushaj – Unë kam pyetjet e mia! E dëgjova edhe përgjigjen e zonjës Dhima.

Si ka qenë bashkëpunimi i institucionit tuaj me institucionet e prokurorisë? Sa denoncime janë bërë dhe si janë monitoruar nga ana juaj?

Gjatë kontrollit të dosjeve, ju thatë se 60% janë klasifikuar të mira dhe 13% e tyre janë klasifikuar të mjaftueshme. Po diferenca prej 27%?

Sa koncesione janë kontrolluar në harkun kohor të një viti... dhe çfarë është konstatuar?

Bujar Leskaj – Faleminderit për pyetjen!

Do të përpiqem të përgjigjem shkurt.

Burimet njerëzore në KLSH-së nuk janë të mjaftueshme, por unë gjithmonë kam mirëkuptuar edhe situatën në të cilën ndodhen edhe institucionet e tjera. Natyrisht, kemi nevojë për disa shtesa në auditues dhe një rikonceptim në strukturë.

Mund të bëjë analizë, të vij ndoshta një ditë tjetër, raportet ndërmjet numrit të audituesve të brendshëm në Republikën e Shqipërisë dhe gjetjet e tyre në krahasim me numrin tonë të gjetjeve. Numri ynë është 4 herë më i vogël dhe gjetjet tona janë disafish më të larta.

Në këtë drejtim, jemi të hapur për çdo mbështetje dhe për çdo shtesë që ju do të mendoni, si Kuvend i Shqipërisë.

Pyetja e dytë, për sa i përket realizimit të planit, ne i dhamë të dhënat për realizimin e auditimeve. Nga 154 auditime që ka qenë plani, ne kemi realizuar 156 auditime. Si plan dhe si numër, i kemi realizuar të gjitha auditimet e përcaktuara, përfshi edhe ato që na ka kërkuar DG Budget dhe që kanë ardhur si refleksione të progresraportit të BE-së. Në faqen 6, në tabelën përkatëse, jepet realizimi i tyre i mbështetur edhe te plani.

Pyetja e tretë, se cilat kanë qenë denoncimet në prokurori. Gjatë vitit 2017 ne kemi realizuar dhe kemi përcjellë 47 kallëzime në prokurori, të cilat kanë qenë kryesisht për shpërdorim detyre. Në raport është një kapitull i veçantë për denoncimet në prokurori. Edhe te doracaku që kemi përgatitur, kallëzimet penale janë në faqet 32, 33, 35 dhe 38. Këtu kemi tabelat me të gjitha kallëzimet penale dhe drejtuesit përgjegjës.

Për sa i përket ndjekjes, kemi 21 procese gjyqësore penale në të cilat kemi kundërshtuar vendimin e prokurorisë për pushim të çështjes.

Ka procese të tjera gjyqësore në të cilat ne jemi palë e tretë, ku janë palë institucionet e qeverisjes vendore apo palë të tjera që janë rekomanduar nga ne. Ne i ndjekim në vijimësi këto.

Kuptohet, ne nuk ndërhyjmë në punën e prokurorisë dhe nuk e komentojmë. Ne komentojmë punën tonë.

Unë e inkurajoj prokurorinë t'u rikthehet çështjeve dhe Prokurores së Përgjithshme, që tashmë nuk mund të quhet e re, i sugjeroj t'i rishikojë kallëzimet tona që janë me brumë dhe kanë vlerë, çuarja deri në fund e të cilave, do t'i shërbente luftës kundër korrupsionit, por ajo është detyrë e prokurorisë. Unë nuk komentoj vendimet e gjyqësorit dhe të prokurorisë. Ky është një parim në punën tonë, si institucion suprem auditimi.

Pyetja tjetër, që ju bëtë për koncesionet. Natyrisht, ne i kemi audituar dhe koncesionet. Përpiqemi të ecim me ritmin dhe me pritshmëritë që ka publiku. Po ju citoj një koncesionin për sa i përket dhënies së përparësisë së zhvillimit ekonomik të zonës Spitallës, Durrës për të cilin kemi bëtë kallëzim në prokurori. Në këtë procedurë janë konstatuar parregullsi në përcaktimin e ofertës fituese, duke manipuluar vlerësimet e ekspertëve për

kriteret specifike në lidhje me masën e investimit të propozuar nga secili ofertues, kriterin e ndikimit mjedisor, kriterin e shkallës së punësimit të komunitetit etj.

Nga KLSH gjykohet se është shpallur fituese oferta jo më e favorshme ekonomikisht, si pasojë e renditjes përfundimtare nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në bazë të kriterëve të vlerësimit. Klasifikimi i gabuar i operatorit ekonomik operatorit 1, në vend të dytë, solli si pasojë potencialisht 54 milionë euro investime të munguara. Kostoja e investimit të operatorit të parë është 93 milionë euro, ndërsa ajo e bashkimit të operatorëve të dytë, është 39 milionë euro, pra 54 milionë euro më pak do të investojë ai, që është shpallur fitues.

E dyta, potencialisht janë 9500 vende pune më pak. Operatori i parë do të punësojë 12 mijë punëtorë, ndërsa bashkimi i operatorëve që janë shpallur fitues do të punësojë 2500 punëtorë.

Potencialisht të ardhurat e munguara në buxhetin e shtetit nga mosrealizimi i kontributeve shoqërore vetëm për një vit, është në shumë 718 milionë lekë.

E katërta, ka risqe të shtuara në ndotjen mjedisore. Operatori 1 do të investojë në magazinat doganore, qendrat e biznesi etj., ndërsa bashkimi i operatorëve të dytë, që është shpallur fitues, do të investojë edhe në ndërtimin e një fabrike ferro-kromi.

Gjithashtu, janë konstatuar mangësi edhe në disa koncesione të tjera, të cilat janë në faqet 38, 39 dhe 40 të raportit tonë vjetor të performancës, i cili ndodhet këtu.

Ne presim të thirremi nga Komisioni i Ekonomisë dhe po në të njëjtën ditë e vendosim edhe në faqen *web* të KLSH-së. Sot raporti është vendosur në faqen *web* të KLSH-së, në kuadër të programit të transparencës që ne kemi.

Erion Braçe –Faleminderit shumë, zoti Leskaj edhe për raportimin, edhe për përgjigjet e pyetjeve nga kolegët deputetë!

Unë desha të them disa fjalë në përfundim të këtij raportimi.

Natyrisht, më vjen mirë (edhe për shkak të kohës së gjatë që kam në Kuvend), të vërej me kënaqësi rritjen e standardit jo vetëm të raportimit të KLSH-së, por edhe punës së bërë në raport në lidhje me objektivat e përcaktuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, por edhe nga ligji organik (i riu apo edhe i mëparshmi), që është detyrim për t'u zbatuar. Pikërisht kjo punë ka rezultatet e veta. Treguesit janë domethënës, qoftë në auditimet e kryera nga ju, qoftë edhe në zbulimin e shkeljeve ligjore apo të dëmeve ekonomike të shkaktuara gjatë ushtrimit të detyrës nga funksionarë të ndryshëm në sektorë të ndryshëm të vendit.

Natyrisht, e gjitha i ka shërbyer qartësisht edhe përmirësimit të qeverisjes, qoftë në korporatat publike, qoftë në degë të ndryshme të qeverisjes së vendit. Thënë këtë, pa asnjë diskutim, që vlerësimi i Komisionit të Ekonomisë është pozitiv për angazhimin e KLSH-së në përmbushjen e të gjitha angazhimeve dhe objektivave të përcaktuara jo vetëm në dokumentet tuaja të punës, por edhe në rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë.

Natyrisht, deklarimi juaj sot këtu dhe angazhimi që keni marrë për t'i dhënë fund mandatit tuaj dhe për të mos rikandiduar, është një problem më tepër për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në kushtet në të cilat ndodhemi dhe natyrisht, do të kërkoj jo vetëm angazhimin e këtij komisioni, por edhe një proces midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me qëllim që të mos shkaktohet asnjë boshllëk i ardhur nga marrëdhënia politike në krye të KLSH-së.

Thënë këtë, do të doja të theksoja shumë qartë, që standardet e aplikuara deri më sot nga Komisioni i Ekonomisë, nuk do të ndryshojnë, por do të jenë të njëjta për të gjykuar cilëndo kandidaturë, që do të paraqitet para këtij komisioni, si kandidaturë e mundshme për të drejtuar nesër KLSH-në.

Meqë jemi në këtë pikë, do të doja të veçoja në këtë aspekt edhe ndihmën e çmuar të KLSH-së në funksion të këtij komisioni edhe në procese të tjera. Më konkretisht, do të doja t'ju falënderoja për auditimin dhe për vlerësimin që ju keni bërë për Komisionin e Prokurimit Publik, i cili ndihmoi edhe komisionin tonë të gjykonte me drejtësi në një proces përzgjedhjeje të anëtarëve të rinj të Komisionit të Prokurimit Publik, vendosjen që aty të një standardi, duke marrë parasysh edhe të gjitha gjetjet e KLSH-së në atë rast, i cili duhet të jetë i pakalueshëm për cilindo tjetër, që do të paraqitet përsëri para këtij komisioni për të plotësuar vendet vakante në Komisionin e Prokurimit Publik.

Së dyti, pa asnjë diskutim, edhe unë, edhe ju, edhe kolegët deputetë e kujtojmë se procesi i miratimit të ligjit organik për KLSH-në, ka qenë një proces i vështirë. Është ashtu siç thoni ju. Mund të ketë boshllëqe në këtë ligj, të cilat në rast se plotësohen, i japin një autonomi më të plotë financiare KLSH-së, por jo vetëm. Kështu, ne jemi të hapur dhe unë besoj se do të shprehet edhe në rezolutë, që për të dyja ndryshimet që adresuat edhe ju në komision gjatë raportimit tuaj, qoftë ai për të drejtën për të ankimuar buxhetin e KLSH-së, në raport me vendimet që merr edhe Ministria e Financave, edhe Kuvendi në lidhje me buxhetin tuaj, por edhe tjetri, për të certifikuar audituesit e jashtëm nga institucioni juaj, natyrisht do të jenë propozime të vlefshme dhe të diskutueshme. Në momentin të parë të

mundshëm, që ju do të jeni gati për t'i prezantuar ato para këtij komisioni dhe ne natyrisht për të marrë një iniciativë ligjore për t'ia paraqitur Kuvendit në një rast sa më të afërt.

Së treti, pa asnjë diskutim që cilësia e kontrolleve dhe e auditimeve të kryera, veçanërisht në aspektin e ri për të cilin ju folët, auditimin e performancës, është një element kyç që e rrit kredibilitetin e KLSH-së. Ky është një standard i ri i vendosur dhe natyrisht, për këtë meritoni përgëzime.

Në rast se ne do të kishim një formë më të thjeshtuar të të gjitha gjetjeve tuaja, të prezantuar edhe me zëra, si ky detajim që bëmë bashkërisht për vlerën e lartë prej 92,7 miliardë lekësh, të shoqëruar me rekomandime më specifike, më konkrete, pa diskutim, që edhe puna jonë do të ishte më efikase në raport me këtë. Thënë kjo, pa diskutim, unë e gjej të patolerueshme qoftë situatën shumëvjeçare në Agjencinë e Burimeve Natyrore, qoftë situatën shumëvjeçare në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

Pa asnjë diskutim, unë jam shumë i lumtur që në fund të këtij vitit mbaron me ligj afati i mbylljes së lojërave të fatit, por kjo nuk do të thotë që gjetjet dhe rekomandimet tuaja për zhdëmtimin e dëmeve të krijuara me një vlerë llahtarisht të madhe, jo në raport me përfitimet nga lojërat e fatit, që mund të duken fare të vogla në raport me përfitimet e asaj industrie, prandaj duhet të zhdëmtohen qindarkë më qindarkë. Kjo do të jetë në rezolutën e Kuvendit dhe nuk diskutohet.

Së fundi, pa asnjë diskutim, që ne, si Komision i Ekonomisë do të vijojmë të kemi kërkesat tona edhe për auditimet e posaçme nga KLSH-ja, pa e vënë në diskutim për asnjë minutë pavarësinë tuaj për ushtrimin e detyrës suaj, për të bërë kontrollet e domosdoshme të ligjshmërisë apo të performancës në të gjitha degët e qeverisjes apo për çdo vendimmarrje të qeverisjes së vendit.

Më lejoni t'ju them se e çmoj shumë raportin tuaj për BSH-në, edhe pse konfidencial. Dua t'ju kujtoj se privatizimi i hotel "Dajtit" është një nga çështjet e nxehta ende të pazbardhura, të pahetuara (për fat të keq), nga Prokuroria e Përgjithshme.

Meqë kam marrë spunto në këto përfundime nga interesi i deputetëve të këtij komisioni përballë jush dhe natyrisht, duke gjetur të gjithë mirëkuptimin dhe gatishmërinë tuaj për ta audituar këtë çështje, ashtu siç ka ndodhur, pa nxjerrë ndonjë sekret.

Kur kërkuam auditimin e kësaj çështjeje, nuk e dinim këtë dimension që kishit zbuluar ju në një raport tejet profesional, dhe natyrisht, shumë të rëndësishëm. Askujt nuk i shkonte ndër mend se ishte cenuar ligji për Bankën e Shqipërisë apo parimet e politikës

monetare midis BSH-së në standardin e saj të pavarësisë dhe të mosfinancimit të drejtpërdrejtë të qeverisë të Republikës së Shqipërisë, që janë parime ndërkombëtare, të njohura botërisht.

Thënë këtë, unë e marr të gjetur pyetjen e zonjës Gjylameti pak më parë, për të vijuar më tutje hetimin e plotë të të gjithë kësaj historie dhe për të pasur një konkluzion të qartë për privatizimin e hotel “Dajtit” në të gjithë dimensionin e tij, që nga vendimet, prokurimet e të tjerat me radhë, deri te historia e cenimit të politikës monetare në një moment kyç, me një operacion banal, në favor të një qeverie të caktuar. Pikërisht se kërkesat tona kundrejt jush kanë gjetur gjithmonë vëmendje dhe kanë shkuar deri në fund me auditime serioze dhe cilësore, pavarësisht se ju thoni që ju mbaron mandati, unë do të paraqes kërkesën time për dy çështje të tjera.

Unë mendoj që ky vend ka nevojë për një ekuilibër të ri të shfrytëzimit të burimeve natyrore në raport edhe me ndikimin në mjedis. Konkretisht, historia e koncesioneve për ndërtimin e hidrocentraleve në çdo rrëke të vendit duhet të adresohet në mënyrë urgjente. Ajo ka krijuar një sensibilitet shumë të madh social në zona të caktuara të vendit, ashtu siç ka krijuar një sensibilitet akoma më të madh në segmente të caktuara që monitorojnë këto zhvillime, veçanërisht ndikimin në mjedis, në të gjithë Europën.

Kështu që, do t’ju lutesha të pranoni kërkesën time për të audituar këtë fenomen, me fokus të posaçëm nevojën e Shqipërisë për të zhvilluar burimet e saj energjetike, por edhe për të gjetur një ekuilibër shumë të qartë për të mbrojtur mjedisin në këtë vend, që është gjithnjë ai që ka qenë dhe mbetet një vend i vogël.

Përtej çështjes së koncesioneve, për shkak të këtij ekuilibri të ri unë ju kërkoj të auditoni edhe lejet minerare dhe ndikimin e tyre në mjedis, sidomos ato që nuk kanë të bëjnë thjesht dhe vetëm me hapje minierash për shfrytëzimin e resurseve minerare që ne kemi, por mbi të gjitha lejet minerare që po rrënojnë male të tërë, duke pasur një impakt ekonomik minimal në ekonominë e madhe kombëtare, por duke sjellë një dëm kolosal mjedisor në ato zona ku janë, por edhe në të gjithë territorin e vendit.

Së treti, nuk dua që të keqkuptohem, qoftë nga ju, qoftë nga institucioni dhe nuk dua të ushtroj absolutisht asnjë lloj ndikimi në vendimin që ju duhet të merrni, por kam një kërkesë, që buron që nga viti 2007.

Në atë periudhë Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar procedurat e prokurimit për ndërtimin e rrugës Rrëshen-Kalimash-Kukës-Morinë. Zhvillimet e fundit dhe avancimi i një projekti, tashmë të kalimit në një stad tjetër, jo vetëm për përfundimin e asaj rruge, por edhe për mirëmbajtjen me koncesion, më shtyn të kërkoj nga Kontrolli i Lartë i Shtetit që të bëj

një auditim të plotë të ndërtimit të rrugës Rrëshen-Kalimash-Kukës-Morinë me qëllim që të fillojmë të kuptojmë sa para kemi paguar, çfarë vepre kemi ndërtuar, çfarë kemi lënë mangët dhe sa para të tjera duhet të paguajmë si qytetarë të këtij vendi për të përfunduar një vepër dhe për ta mirëmbajtur atë në kohë.

Nuk kam asnjë lloj ndjesie politike për këtë çështje. E kam mbyllur historinë e ndjesive politike për këtë rrugë. Shqetësimi i vetëm është ky që sapo artikulova, me qëllim që nga ky auditim të kuptojmë leverdinë ekonomike të kësaj rruge dhe çfarë ne duhet të bëjmë më tej, jo vetëm brenda territorit të Shqipërisë, por edhe me partnerët tanë kufitarë, Kosovën, Maqedoninë, Serbinë, për t'i dhënë kësaj rruge leverdinë ekonomike të këtij investimi, që ishte kolosal dhe vazhdon të mbetet kolosal jo vetëm për ekonominë kombëtare, por edhe për xhepat e qytetarëve të republikës së Shqipërisë.

Duke e mbyllur dua t'ju falenderoj edhe një herë për punën e bërë! Unë besoj që ky nuk do të jetë takimi i fundit me ju. Pa asnjë diskutim ky komision është i interesuar dhe do ta vendosë standardin, që ju propozuat, të një procesi të qartë llogaridhënieje në fund të mandatit të çdo drejtuesi të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Kështu që, në një ditë të lirë për Kuvendin, por edhe për ju, jeni të mirëpritur në Kuvendin e Shqipërisë për të bërë një prezantim të gjithë punës suaj 7-vjeçare. Mund ta bëni me shkrim, me gojë apo me çdo element tjetër këtu para Kuvendit. Ne do të jemi të nderuar t'ju dëgjojmë në këtë raportim, sepse jo vetëm procesi i përgjegjshmërisë ndaj Kuvendit, por edhe procesi serioz i llogaridhënies së çdo drejtuesi institucioni kushtetues të zgjedhur në Kuvend do të jetë një standard i ri i vendosur në Kuvend.

Që ta bëjmë punën deri në fund, unë kam përpara një projektvendim, të cilin do t'ia paraqes pak më pas Konferencës së Kryetarëve. Bëhet fjalë për ngritjen e nënkomisionit për transparencën, mbikëqyrjen dhe zbatimin e buxhetit të shtetit dhe të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Do të jetë një nënkomision si të gjithë nënkomisionet e tjera të Kuvendit, por që buron edhe nga një rekomandim i bërë nga institucionet ndërkombëtare që asistojnë Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për këtë çështje.

Unë mendoj që ta kalojmë sot në komision me qëllim që Konferenca e Kryetarëve ta bëjë gati për seancë plenare nesër. Duke filluar nga java tjetër ne do të procedojmë me ngritjen e nënkomisioni për të vijuar punën konkrete në këto dy drejtime: transparencën e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në raport me detyrën e tij.

Pro? Kundër? Nuk ka. Miratohet.

Shumë faleminderit, zoti Leskaj!

Mbledhja mbyllet këtu.

MBYLLET MBLEDHJA